

ANALIZA E SHPENZIMEVE

**TË PËRSHTATSHMËRISË, EFIKASITETIT,
EFEKTSHMËRISË DHE DREJTSHMËRISË
NË FUSHËN E DREJTËSISË PËR FËMIJËT
NË MAQEDONINË E VERIUT**

Autorë:

Prof. dr. i shkencave juridike Misha Dokmanoviç

Prof. dr. i shkencave juridike Darko Spasevski

Prof. dr. Marina Tërpeska

Prof. dr. e shkencave juridike Besa Arifi

Përgatitur nga:

Instituti për Kërkime Strategjike dhe Edukim - IKSE Shkup.

Ky dokument është përgatitur nga ISIE me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe UNICEF-it si pjesë e projektit “Drejt(ësi) për fëmijët - BE për drejtësinë për të miturit dhe drejtësinë miqësore për fëmijët”. Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk duhet të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë qëndrimin zyrtar të UNICEF-it ose të Bashkimit Evropian. Komisioni Evropian nuk është përgjegjës për çdo përdorim që mund të bëhet i informacionit të përmbajtur në këtë dokument.

Për më tepër informacione kontaktoni:

isie@mail.org

Përmbajtja

Shkurtesat	4
Përmbledhja ekzekutive	5
Hyrje	7
Sistemi i drejtësisë për fëmijët në Maqedoninë e Veriut	7
Metodologjia	13
Rezultatet (shpenzimet publike dhe trendët)	17
Konkluzionet	29
Rekomandimet	30
Lista e referencave	31
Shtojca 1 - Kompetencat e autoriteteve të ndryshme konform Planit Operacional për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve (2015-2017)	33

Shkurtesat

ASPI	Agjencia për Mbrojtjen e së Drejtës për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik
BE	Bashkimi Evropian
ICITAP	Programi Ndërkombëtar i Asistencës në Trajnimet për Hetime Kriminale
IEK	Institucioni Edukativo-Korrektues - Tetovë
IKSE	Instituti për Kërkime Strategjike dhe Edukim
J4C	Drejtësia për Fëmijë (origj. Justice for Children)
KPD	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
KSHPD	Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Maqedonisë së Veriut
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale e Maqedonisë së Veriut
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PP	Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
QNPS	Qendra Ndërkombetare për Punë Sociale - Shkup
QPS	Qendra për Punë Sociale
SCPCD	State council for prevention of child delinquency

Përmbledhja ekzekutive

Në periudhën maj - dhjetor 2021, Instituti për Kërkime Strategjike dhe Edukim - IKSE Shkup ka zhvilluar një analizë të shpenzimeve të përshtatshmërisë, efikasitetit, efektshmërisë dhe drejtshmërisë së buxhetit shtetëror në fushën e drejtësisë për fëmijët në Maqedoninë e Veriut. Kjo analizë u zbatua në kuadër të projektit të financuar nga BE-ja “Drejtësi për fëmijët – BE-ja për drejtësi për të miturit dhe drejtësi miqësore për fëmijët”, e zbatuar nga UNICEF-i, Maqedonia e Veriut. Qëllimi kryesor i analizës është të ofrojë prova, njohuri dhe mundësi për përmirësimin e rezultateve për fëmijët dhe të japë rekomandime mbi shpërndarjet financiare të nevojitura për zhvillimin e detyrueshëm të kapaciteteve të profesionistëve në sistemin juridik.

Në bazë të fazës së gjerë të shqyrtimit në zyrë, kërkesave për qasje të lirë në informacione publike që iu dërguan 168 institucioneve (qendrave për punë sociale, gjykatave, njësive të vetëqeverisjes lokale, ministrive, prokurorisë publike, këshillave, agjencive etj.) dhe dokumentacionit shoqëruar, u identifikuan **konkluzionet** e mëposhtme mbi përshtatshmërinë, efikasitetin, efektshmërinë dhe drejtshmërinë e buxhetit të qeverisë në fushën e drejtësisë për fëmijët në vend:

- ▲ Mungon një qasje sistematike për shpenzimet e qeverisë në nivelin kombëtar dhe atë lokal në lidhje me drejtësinë për fëmijët. Në bazë të kërkimit kompleks që u zbatua, u mbledhën vetëm informacione të pjesshme mbi shpenzimet specifike për disa institucione. Disa institucione me relevancë të lartë¹ nuk dorëzuan përgjigje zyrtare, edhe pse është ngritur një procedurë ankimore. Në disa raste u identifikua një mospërputhje mes informacioneve të paraqitura në përgjigjet zyrtare dhe në raportet financiare zyrtare, bilancet, faqet e internetit etj. Si rezultat i kësaj, mund të konkludohet se sistemi i klasifikimit buxhetor të zërave dhe llogarive nuk siguron se programet kyçe të drejtësisë për fëmijë janë të identifikueshme dhe se ato kanë zëra dhe programe të qarta buxhetore, me të cilat mund të vlerësohet me saktësi se sa përcakton qeveria për këtë qëllim.
- ▲ Disa institucione kanë theksuar se shpenzimet

e përcaktuara për drejtësinë për fëmijët nuk përlogariten ndaras, por së bashku me shpenzimet e tjera të ngjashme, konform klasifikimit të shpenzimeve të lëshuar nga Ministria e Financave. Është ky rasti me pothuajse të gjitha institucionet që aktualisht kanë shpenzuar shumën të caktuar për drejtësi për fëmijët. Disa nga institucionet dorëzuan përgjigje të pjesshme ose jo të plota, siç shënohet më poshtë në studim.

- ▲ Disa institucione që u kontaktuan qoftë me anë të kërkesave për qasje të lirë në informacione me karakter publik, qoftë me anë të intervistave, kanë treguar se institucionet nuk janë në dijeni se janë pjesë e Planit Operacional për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve.² Këto institucione janë: Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Agjencia për Rini dhe Sport, Dhoma e Avokatisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Qendra për Arsimimin e të Rriturve, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Zyra e Avokatit të Popullit etj.
- ▲ Procedura e parashikuar për hartimin e buxhetit kombëtar zhvillohet në mënyrë të përgjithshme pa pasur hapësirë për ndërhyrje konkrete dhe fleksibilitet. Mospasja e programit specifik dhe llogarisë për drejtësinë për fëmijët kufizon fleksibilitetin e fondeve që duhet të përcaktohen dhe/ose të kërkohen me anë të buxhetit.
- ▲ Sektori i drejtësisë për fëmijë merr një sasi shumë të kufizuar donacionesh nga donatorë vendas dhe ndërkombëtarë. Donacionet evidentohen në kontabilitetin zyrtar në të dy rastet (donacione vendase dhe ndërkombëtare), kur merren produkte ose para të gatshme për të cilat shumica e institucioneve kanë llogari të veçantë të destinuar vetëm për donacione. Është evidente se shërbimet në këtë sektor nuk varen nga donatorët.
- ▲ Pjesëmarrja e stafit në trajnimet lidhur me drejtësinë për fëmijët mbetet të jetë e kufizuar. Stafi i përfshirë në trajnimet lidhur me drejtësinë për fëmijët është i punësuar në QPS dhe më së shpeshti trajnimet janë pa pagesë, të organizuara nga QNPS-ja dhe rrjedhimisht nuk kanë fare implikime financiare.
- ▲ Përderisa në disa komuna janë themeluar këshilla lokale për parandalimin e delikuencës së fëmijëve (sipas informacioneve të dorëzuara - janë 31),

¹ Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Komunat e Gazi Babës, Gostivarit, Likovës dhe Tearcës.

² Plani Operacional për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve (2015-2017), Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve.

vetëm 2 komuna kanë shpenzuar aktualisht mjete për funksionimin e Këshillit. Shuma mbetet dukshëm e ulët - nën 60.000,00 denarë (1.000.00 euro) në nivelin vjetor. Në përmasa të mëdha, këshillat nuk janë në funksion.

- ▲ Vetëm tri gjykata në Maqedoninë e Veriut kanë theksuar se ndajnë fonde për drejtësi për fëmijët. Mesatarisht, këto tri gjykata kanë përcaktuar dhe shpenzuar gjithsej 800.000,00 denarë (13.000,00 euro) në bazë vjetore.
- ▲ Qeveria nuk ka buxhetuar ose shpenzuar fonde për procedura ndërmjetësimi në periudhën e përmendur më lartë.
- ▲ Pothuajse në asnjërin nga institucionet e analizuar nuk janë miratuar akte të veçanta që rregullojnë buxhetimin e zërave dhe metodologjinë për përcaktimin e nevojave të institucioneve lidhur me Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët.

Në bazë të kërkimit të zbatuar dhe konkluzioneve të identifikuar, **rekomandohen** masat e mëposhtme për të adresuar çështjet në fjalë:

- ▲ Krijimi i një programi të ri buxhetor që do të shfrytëzohet nga të gjitha organet kompetente për zbatimin e Ligjit të Drejtësisë për Fëmijët për të kërkuar fonde në lidhje me këtë ligj;
- ▲ Vendosja e një nënzëre të re ose nënzërave (llogari 6-shifrore) në Buxhet përmes të të cilave do të realizohen fondet në lidhje me Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët. Duke pasur parasysh numrin e madh të institucioneve të përfshira, kjo qasje do të sigurojë një monitorim më të mirë të fondeve të shpenzuara për drejtësinë për fëmijët si dhe kornizë ligjore përmes së cilës institucionet e përfshira mund të kërkojnë dhe shpenzojnë fonde;
- ▲ Zhvillimi i koordinimit më të mirë dhe shkëmbimit të informacioneve ndërmjet institucioneve në kuptimin e detyrimeve që dalin nga Ligji i Drejtësisë për Fëmijët dhe Plani Operacional për Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve. Duhet të krijohet një mekanizëm i mundshëm për raportimin dhe monitorimin e aktiviteteve të të gjitha palëve të interesit të identifikuar, duke përfshirë përgatitjen e raportit vjetor mbi aktivitetet që lidhen me drejtësinë për fëmijët. Raporti duhet t'i dorëzohet një institucioni kompetent të identifikuar me ligj (për shembull, Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve);

- ▲ Mbështetja e vendosjes së mjeteve për shkëmbimin e informacioneve në lidhje me çështjet e drejtësisë për fëmijët brenda institucioneve kompetente. Raportet vjetore të palëve të interesit të identifikuar duhet të përfshijnë informacione mbi aktivitetet që lidhen me drejtësinë për fëmijët;
- ▲ Zhvillimi i zgjidhjes softuerike për nevojat e QPS-së për të evidentuar shpenzimet e shërbimit për drejtësinë për fëmijët, në mënyrë që më mirë të monitorohen përshtatshmëria, efikasiteti dhe efektshmëria e saj;
- ▲ Rishikimi i punës së këshillave lokalë për parandalimin e delikuencës së fëmijëve. Duhet të aplikohet detyrimi për raportim vjetor dhe ose/tremujor. Njësia e vetëqeverisjes lokale duhet të përcaktojë një minimum buxheti për aktivitetet e këshillave lokalë në drejtim të parandalimit të delikuencës së fëmijëve në bazë të madhësisë, popullsisë dhe rekomandimeve të përmendura në këtë raport (200.000,00 denarë në nivelin vjetor). Edhe sfidat shtesë operacionale (përfshirë dhe udhëzimet për madhësinë adekuatë të këshillave, motivimin e anëtarëve që të marrin pjesë aktive në punën e këshillave, si dhe udhëzimet për zhvillimin e programit dhe konceptit të aktiviteteve, etj.) duhet të merren në konsideratë;
- ▲ Duke ditur potencialin e lartë të ndërmjetësimit për zgjidhjen e kontesteve që lidhen me drejtësinë për fëmijët, organet duhet të marrin në konsideratë përcaktimin potencial të fondeve për procedurën e ndërmjetësimit;
- ▲ Hartimi i akteve të veçanta që rregullojnë buxhetimin e zërave dhe metodologjinë për përcaktimin e nevojave të institucioneve lidhur me Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët.
- ▲ Zhvillimi i kapaciteteve të punonjësve për raportim të përpiktë dhe akses të lirë në informacione me karakter publik.

Hyrje

Republika e Maqedonisë së Veriut ka eksperiencë të gjatë në trajtimin e çështjes së drejtësisë për fëmijët. Ndër vite, vendi ka miratuar shumë pjesë të rëndësishme legjislacioni që drejtpërsëdrejti ose tërthorazi kanë rregulluar aspekte të ndryshme të sistemit të drejtësisë për fëmijët. Veç kësaj, vendi ka ratifikuar një sërë konventash ndërkombëtare dhe aktesh të tjera në terren, si dhe ka qenë objekt i monitorimit dhe vlerësimit ndërkombëtar.

Duke pasur parasysh këtë, objektivi i përgjithshëm i kësaj analize është të sigurojë të dhëna dhe prova për të avokuar për investime më të mëdha dhe më të mira në fushën e drejtësisë për fëmijët në Maqedoninë e Veriut. Qëllimi kryesor i analizës është të ofrojë prova, njohuri dhe mundësi për përmirësimin e rezultateve për fëmijët dhe të japë rekomandime mbi shpërndarjet financiare të nevojitura për zhvillimin e detyrueshëm të kapaciteteve të profesionistëve në sistemin juridik.

Në *pjesën e parë* të analizës, u prezantua një pasqyrë e sistemit ekzistues të drejtësisë për fëmijë në vend. Kjo pjesë ka si bazë analizën e disa burimeve kyçe të së drejtës, të dokumenteve përkatëse ndërkombëtare dhe të raporteve të monitorimit.

Metodologjia kërkimore u shqyrtua në *pjesën e dytë* të analizës. Në këtë pjesë të analizës shpjegohen dy segmente kryesore të kërkimit (shqyrtimi në zyrë dhe mbledhja e të dhënave parësore).

Në *pjesën e tretë* të analizës prezantohen rezultatet kryesore të kërkimit. Për arsye të kufizimeve të identifikuar, kjo pasqyrë e informacioneve të disponueshme mbi shpenzimet e qeverisë në fushën e drejtësisë për fëmijët është paraqitur në nivelin institucional dhe sipas renditjes alfabetike.

Në fund të dokumentit, shqyrtohen konkluzionet dhe rekomandimet e identifikuar përgjatë kërkimit.

Instituti për Kërkime Strategjike dhe Edukim - IKSE Shkup ka zhvilluar një analizë të shpenzimeve të përshtatshme, efikasitetit, efektshmërisë dhe drejtshmërisë së buxhetit shtetëror në fushën e drejtësisë për fëmijët në Maqedoninë e Veriut për periudhën maj - nëntor 2021. Kjo analizë u zbatua në kuadër të projektit të financuar nga BE-ja "Drejtësi për fëmijët – BE-ja për drejtësi për të miturit dhe drejtësi miqësore për fëmijët", e zbatuar nga UNICEF-i, Maqedonia e Veriut.

Sistemi i drejtësisë për fëmijët në Maqedoninë e Veriut

Ligji i Drejtësisë për Fëmijët përfaqëson instrumentin kyç juridik për rregullimin e sistemit të drejtësisë për fëmijët në vend. Përveç kësaj, Maqedonia e Veriut është palë në një sërë dokumentesh ndërkombëtare që kanë të bëjnë me drejtësinë për fëmijët, të cilat janë ratifikuar dhe janë duke u aplikuar. Veç kësaj, një numër ligjesh që rregullojnë aspekte të caktuara të drejtësisë për fëmijët janë miratuar nga Kuvendi Kombëtar. Pasqyra e dokumenteve ndërkombëtare dhe legjislacionit kombëtar është paraqitur në një pjesë të Metodologjisë.

Përpara miratimit të Ligjit të Drejtësisë për Fëmijët, u aprovua Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve (2010-2020). Ky dokument ka promovuar tri shkallë të ndërhyrjes: (1) parandalimin parësor, (2) parandalimin dytësor dhe (3) parandalimin terciar.

Objektivi i *parandalimit parësor* është të krijojë mjedis mbrojtës për të gjithë fëmijët, duke përfshirë qasjen sistematike me anë të dhënies së mbështetjes qeveritare, ndërtimit të kapaciteteve, reformës ligjore, monitorimit dhe denoncimit të shkeljes së të drejtave të fëmijëve, ndryshimit të qëndrimit të popullsisë së përgjithshme dhe të profesionistëve që punojnë me fëmijë, zhvillimit të shkathtësive personale të fëmijëve dhe familjeve. Parandalimi parësor përfshin aktivitete që kanë të bëjnë me procesin e risocializimit brenda familjeve, sistemin arsimor, sistemin shëndetësor, masat e ndërgjegjësimit publik që duhet t'i ndërmarrë komuniteti etj.³

Parandalimi dytësor synon fëmijët në rrezik nga kryerja e veprës penale ose që kanë kryer veprë penale, por që nuk mbahen përgjegjësi për veprën penale. Është i lidhur ngushtë me paralajmërimin e hershëm të të rinjve në rrezik ose me parashikimin e fëmijëve dhe familjeve në rrezik. Strategjia parashikon direktiva në disa fusha, duke përfshirë: 1. Arsimin; 2. Shëndetësinë; 3. Qendrat për Punë Sociale; 4. Policinë; 5. Komunitetin lokal.⁴

Parandalimi terciar përqendrohet tek programet parandaluese, të cilat do t'u mundësojnë fëmijëve

³ Burimi: Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve (2010-2020), p. 14

⁴ Idem, p. 19-20.

të marrin përgjegjësinë për veprën e kryer penale dhe për pasojat e saj, si dhe do të parandalohet përsëritja e veprës. Strategjia jep drejtime në kuptimin e masave dhe mekanizmave alternative të parandalimit dhe mbrojtjes përmes sistemit formal dhe ndërmjetësimit, kujdesit dhe shërbimeve institucionale, kujdesit dhe shërbimeve pas largimit nga institucionet, si dhe në sektorin e shëndetësisë.⁵

Në pajtim me Planin Operacional për Implementimin e Strategjisë Kombëtare të Parandalimit të Delikuencës së Fëmijëve (2015-2017), parashikohen institucionet/palët e interesit si më poshtë:

të zbatohen nga Shtetet Palë në Konventë, duke përfshirë:

- ▲ mundësinë e fëmijës që të dëgjohet në çdo procedurë gjyqësore dhe administrative që prek fëmijën, qoftë drejtpërsëdrejti, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose një organi kompetent, në një mënyrë që është në përputhje me rregullat procedurale të ligjit kombëtar (neni 12);
- ▲ detyrimin e palëve për të marrë të gjitha masat e duhura juridike, administrative, shoqërore dhe edukative për të mbrojtur fëmijën nga të gjitha

Tabela nr. 1 - Institucionet e parandalimit parësor, dytësor dhe terciar

Parandalimi parësor	Parandalimi dytësor	Parandalimi terciar
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale	Ministria e Drejtësisë
Ministria e Arsimit dhe Shkencës	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	Drejtoria për Zbatimin e Sanksioneve
Këshillat Komunalë për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve	Instituti i Veprimtarive Sociale	Gjykata me juridiksion të zgjeruar
Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve	Byroja për Zhvillimin e Arsimit	Qendrat për Punë Sociale
Ministria e Punëve të Brendshme	Qendra për Punë Sociale	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Njësitë e Vetëqeverisjes	Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale	Qendra për Arsimimin e të Rriturve
Ministria e Shëndetësisë	Qendrat e Shëndetësisë	Zyra e Prokurorisë Publike
Qendrat e Shëndetësisë	Ministria e Punëve të Brendshme	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale	Ministria e Vetëqeverisjes Lokale	Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale
Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës	Këshillat Komunalë për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve	
Avokati i Popullit	Ministria e Shëndetësisë	
Dhoma e Avokatisë		
Ministria e Drejtësisë		

Duhet të merren në konsideratë edhe detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut në kuptimin e zbatimit të Konventës për të Drejtat e Fëmijës. Maqedonia e Veriut është shtet palë i Konventës që nga viti 1993. Disa nene të Konventës janë të një rëndësie të madhe për zhvillimin e sistemit kombëtar të drejtësisë për fëmijët dhe për mbrojtjen e fëmijës. Ndër të tjera, Konventa ka parashikuar një sërë detyrimesh që do

format e dhunës fizike ose mendore, lëndimi ose abuzimi, neglizhenca ose trajtimi neglizhues, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, duke përfshirë procedurat efektive për krijimin e programeve shoqërore për dhënien e mbështetjes së nevojshme për fëmijën dhe për ata që kujdesen për fëmijën (neni 19);

- ▲ detyrimin e shteteve palë për të mbrojtur fëmijën nga të gjitha format e eksploatimit seksual dhe abuzimit seksual (neni 34);

⁵ Idem, p. 24-25.

- ▲ detyrimin për të mbrojtur fëmijën nga të gjitha format e tjera të eksploatimit që dëmtojnë çdo aspekt të mirëqenies së fëmijës (neni 36);
- ▲ ndalimin e torturës ose trajtimit apo dënimit tjetër mizor, çnjerezor ose poshtërues; ndalimin e heqjes së lirisë në mënyrë të paligjshme ose arbitrare; detyrimin për të trajtuar me njerëzi dhe respekt për dinjitetin e qenësishëm të personit njerëzor të çdo fëmijë të privuar nga liria (neni 40).⁶

Për më tepër, Republika e Maqedonisë së Veriut është lëndë e monitorimit të vazhdueshëm që kryhet nga organizata ndërkombëtare dhe të brendshme.

Raportet e Progresit të Bashkimit Evropian (BE) (2018-2021) në fushën e drejtësisë për fëmijët kanë identifikuar një sërë sfidash urgjente që duhet të adresohen, përfshirë këtu dhe jopërmirësimin e kushteve materiale dhe disponueshmërisë së aktiviteteve edukative dhe të risocializimit për fëmijët e paraburgosur, si dhe fuqizimin e Këshillit Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve dhe të këshillave lokalë.

Raporti i Progresit i BE-së i vitit 2018 ka gjetur se burimet e Këshillit Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve janë të pamjaftueshme dhe se ka mungesë të shërbimeve edukative, shëndetësore dhe shoqërore për fëmijët e paraburgosur. Për më tepër, ky raport ka gjetur edhe se qasja në ndihmë juridike për njerëzit më të cenueshëm (përfshirë fëmijët) pengohet nga kriteret kufizuese në ligjin dhe se vetëm 50% të numrit tanimë të ulët të kërkesave për ndihmë juridike miratohen.⁷

Raporti i Progresit i BE-së i vitit 2020 rekomandon se vendi duhet të përmirësojë shërbimet komunitare për të identifikuar fëmijët në rrezik dhe për të mbështetur fëmijët viktimë të dhunës. Për më tepër, ky raport rekomandon hartimin e një strategjie kombëtare e cila do të promovojë dhe do të shoqërohet me një buxhet përkatës, si dhe identifikimin e modeleve sektoriale të cilat do të ofrojnë shërbime efektive për fëmijët, përfshirë

edhe në nivelin lokal. Raporti kritikon zbatimin e Ligjit të Drejtësisë për Fëmijët, duke kërkuar kështu përmirësime në zbatimin e tij, veçanërisht të rregullave të qasjes në drejtësi, të përfaqësimit juridik dhe të kapacitetit të zyrtarëve publikë të përfshirë në trajtimin e fëmijëve viktimë, fëmijëve dëshmitarë dhe fëmijëve në konflikt me ligjin. Raporti ka gjetur se nuk ka pasur përmirësime në kushtet materiale dhe në disponueshmërinë e aktiviteteve të edukimit dhe risocializimit për fëmijët e paraburgosur. Raporti kërkon përforcimin e rolit të Këshillit Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve, si dhe kapacitetet e këshillave lokalë. Raporti gjithashtu shënon se kujdesi shëndetësor në burgjet mbetet çështje e një shqetësimi serioz, duke përfshirë edhe në kuptimin e të miturve dhe trajtimin e varësisë nga droga.⁸

Raporti i fundit i progresit i BE-së për Maqedoninë e Veriut për vitin 2021 nënvizon nevojën për një përmirësim më të mirë të Ligjit të Drejtësisë për Fëmijët, si dhe një qasje më të sistemuar ndërsektoriale në zbatimin e ligjit. Ndërkaq, raporti thekson nevojën për përforcimin e rolit të Këshillit Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve dhe të kapaciteteve të këshillave komunalë.⁹

Edhe Strategjia e BE-së për të Drejtat e Fëmijës, veçanërisht në pjesën e “Drejtësisë Miqësore për Fëmijët” është marrë në konsideratë në përgatitjen e metodologjisë së këtij kërkimi. Sipas Strategjisë, të gjitha vendet anëtare të BE-së e kanë për detyrë të sigurojnë se interesat në të mirë të fëmijës janë konsiderata parësore në çdo veprim që prek ata. Kjo konsideratë ka një rëndësi të posaçme kur fëmijët përfshihen në procedura gjyqësore penale ose civile.¹⁰

Dokumentet e analizuara që përmenden më poshtë ofrojnë informacione mbi zbatimin e legjislacionit kombëtar, si dhe dokumentet ndërkombëtare në fushën e parandalimit të delikuencës së të

⁶ Kombet e Bashkuara, Konventa për të Drejtat e Fëmijës, e disponueshme në: <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.aspx> [qasur më 15 shtator, 2021].

⁷ Komisioni Evropian, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Raporti për vitin 2018, i disponueshëm në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2019-05/20180417-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-report.pdf> [qasur më 22 tetor, 2021].

⁸ Komisioni Evropian, Maqedonia e Veriut, Raporti për vitin 2020, i disponueshëm në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/north-macedonia-report-2020.pdf> [qasur më 25 tetor, 2021].

⁹ Komisioni Evropian, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Raporti për vitin 2021, i disponueshëm në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/north-macedonia-report-2021_en [qasur më 22 janar, 2022].

¹⁰ Komisioni Evropian, Strategjia e BE-së për të Drejtat e Fëmijës dhe Garancia Evropiane për Fëmijët, E disponueshme në: https://ec.europa.eu/info/policies/justice-and-fundamental-rights/rights-child/eu-strategy-rights-child-and-european-child-guarantee_en#documents [Qasur më: 26 tetor, 2021].

miturve. Siç do të sqarohet në këtë raport, ka një larmi ligjesh, aktesh nënligjore dhe dokumentesh ndërkombëtare që janë të aplikueshme në këtë fushë. Aplikimi i standardeve në lidhje me drejtësinë për fëmijët mund të analizohet nga dy aspekte:

1. Miratimi i legjislacionit kombëtar të RMV-së në kuptimin e integritit të standardeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me delikuencën e fëmijëve, dhe
2. Aplikimi në praktikë i standardeve të inkuorporuara ndërkombëtare.

RMV-ja ka bërë përpjekje në ndryshimin e legjislacionit të vet kombëtar, për të inkuorporuar standardet ndërkombëtare në fushën e drejtësisë për fëmijët. Mund të shënohet se me analizimin e dokumenteve të përmendura më poshtë, shumica e standardeve ndërkombëtare tanimë bëjnë pjesë të legjislacionit kombëtar. Megjithatë, aplikimi i këtyre standardeve në praktikë mbetet të jetë një sfidë, siç shënohet në raportet e BE-së mbi progresin, të përmendura më lartë.

Në kuptimin e qasjes së të drejtës penale, legjislacioni kombëtar që ka të bëjë me drejtësinë për fëmijët, kategorizon fëmijët në tri kategori kryesore: fëmijët në rrezik, fëmijët në konflikt me ligjin dhe fëmijët viktimë të krimit. Është ky kategorizimi që është përcaktuar me Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët, i cili rregullon të drejtat dhe mbrojtjen për çdo kategori të fëmijëve, si dhe pozitën e tyre në procedurat e së drejtës penale.

Në përputhje me nenin 1 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe siç përcaktohet me sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të gjithë personat që kanë arritur moshën 18 vjeç, kanë statusin e fëmijës. Me të mbushurit 18 vjeç personi bëhet i rritur, dhe përfiton kapacitetin e plotë juridik.

Kodi Penal i vendit ofron trajtim të posaçëm për fëmijët si kundërvajtës penal. Në këtë kontekst, dhe në kuptimin e drejtësisë penale, të gjithë personat që nuk kanë arritur moshën 14 vjeç në çastin e kryerjes së veprës penale, kualifikohen për statusin e fëmijës dhe nuk mund të ngarkohen me vepër penale. Një i mitur mund t'u nënshtrohet masave korrektuese dhe të sigurisë në qoftë se në kohën e kryerjes së veprës penale, ai ka qenë në moshën nën 14 vjeç. Të miturit në moshën midis 16 dhe 18 vjeç mund të mbahen juridikisht përgjegjës vetëm për kundërvajtje më serioze penale, dhe mund të dënohen me burgim. Në qoftë se gjatë procedurës provohet se kur i mituri ka kryer kundërvajtjen penale, ai në fakt ka qenë nën moshën 14 vjeç, atëherë procedura penale ndërpritet menjëherë,

dhe organi kompetent i paraburgimit informohet në mënyrën korrekte.

Ligji i Drejtësisë për Fëmijët i miratuar në vitin 2013 nuk përdor termin "i mitur", ai i referohet termit "fëmijë" për të gjithë personat nën moshën 18 vjeç. Ky ligj bën dallimin midis fëmijës në rrezik në moshë midis 7 dhe 14-vjeç, fëmijës në rrezik në moshë midis 14 dhe 16 vjeç dhe fëmijës në rrezik në moshë midis 16 dhe 18 vjeç. Gjithashtu bën dallimin midis fëmijës në konflikt me ligjin në moshë midis 14 dhe 16 vjeç, fëmijës në konflikt me ligjin në moshë midis 16 dhe 18 vjeç dhe fëmijës viktimë. Ligji sugjeron kategorinë e të rriturve të rinj si persona në moshë midis 18 dhe 21 vjeç. Ligji parashikon një procedurë të posaçme penale, ku kryerësi i veprës penale është fëmijë në moshë nën 18 vjeç. Kjo procedurë rregullohet në kuadër të Ligjit të Drejtësisë për Fëmijët dhe siguron masa të mbrojtjes së fëmijës në rolin e të pandehurit, viktimës ose dëshmitarit. Ligji rregullon procesin e kompensimit të dëmit të shkaktuar nga fëmija viktimë. Për më tepër, ligji numëron masat e diversitetit, të cilat janë kryesisht edukative për fëmijët në konflikt me ligjin. Është me rëndësi të mbahet mend se së pari duhet të aplikohen masat edukative, dhe të mbahen masat institucionale si opsioni i fundit. Masat institucionale të cilat përfshijnë dërgimin e fëmijës në institucione të vëzhgimit të shtuar, si dhe në institucionet korrektuese për dënimet me burgim mund të përbëjnë rrezik për procesin e risocializimit të fëmijës dhe mund të ndikojnë stigmatizimin e fëmijës pasi ai/ajo lëshohet nga këto institucione. Është pikërisht për këtë arsye se kur bëhet fjalë për procedurë penale kundër një fëmije në konflikt me ligjin, prokurori ndjek parimin e mundësisë (që nënkupton se prokurori vendos nëse ai/ajo do të padisë fëmijën në konflikt me ligjin, ose nëse ai/ajo do të orvatet të gjejë mundësi të tjera për ta adresuar çështjen, të tilla si procedura e ndërmjetësimit ose negocimit për pranim të fajit), në vend të parimit të legalitetit (që nënkupton se prokurori është i detyruar të padisë nëse ka prova se vepra penale është kryer).

Raportet vjetore të Këshillit Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijës (2018-2020) sugjerojnë probleme të caktuara që raportohen çdo vit. Numri i fëmijëve në rrezik sa shkon e rritet çdo vit (në vitin 2019 janë raportuar 20% më shumë fëmijë në rrezik, krahasuar me vitin 2018). Nga ana tjetër, numri i përgjithshëm i fëmijëve në konflikt me ligjin tregon shenja rënieje (në vitin 2019 janë raportuar 7% më pak raste të fëmijëve në konflikt me ligjin, krahasuar me vitin 2018). Raportet tregojnë një numër shqetësues të ulët të fëmijëve që kanë përfituar të drejtën e këshilltarit (avokatit) kur kanë qenë në stacion policor. Në vitin 2019 ka

një numër po ashtu shqetësues i rritur i fëmijëve viktimë, të identifikuar në qendrat për punë sociale, në krahasim me numrin e ulur të fëmijëve viktimë të identifikuar në gjykatat. Trend pozitiv sipas këtij raporti është numri i ulët i fëmijëve që janë në paraburgim dhe rënia e përdorimit të paraburgimit si masë sigurimi të pranisë së fëmijës në procedurën penale. Ky raport kritikon mungesën e përdorimit të mekanizmave të drejtësisë restauruese, nga gjykatat dhe prokuroritë publike. Në fund, raporti kritikon faktin se gjykatat nuk kanë arritur asnjë vendim mbi kompensimin e fëmijëve viktimë në tërë vitin 2019.¹¹

Raporti Vjetor i vitit 2020 i Institutit të Veprimtarive Sociale sugjeron rëndësinë e trajtimit të mbrojtjes së fëmijëve në rrezik gjatë pandemisë dhe numëron masat që janë ndërmarrë për të edukuar stafin që punon me fëmijë në rrezik, me fëmijë në konflikt me ligjin dhe me fëmijë viktimë në këtë kuptim.¹²

Avokati i Popullit i RMV-së po ashtu ka sugjeruar nevojën e veçantë për përkujdesje për fëmijët në rrezik dhe fëmijët viktimë gjatë kohës së pandemisë. Avokati i Popullit ka sugjeruar se ka progres në deinstitutionalizimin e fëmijëve në rrezik nga institucionet shtetërore dhe vendosjen e tyre në familje përkujdesëse, megjithatë, ka nënvizuar se ka nevojë për kujdes dhe mbrojtje të posaçme për fëmijët-viktimë të veprave penale seksuale dhe viktimë të trafikimit me qenie njerëzore.

Sa i përket masave institucionale për përkujdesjen ndaj fëmijëve me vështirësi dhe sjellje, Raporti i vizitës së Institucionit Publik të Institutit të Kujdesit, Rritjes dhe Arsimimit të Fëmijëve dhe të Rinjve "Ranka Millanoviç" (2019) ka dhënë një vështrim mjaft kritike për kushtet e jetesës në këtë institucion. Konkluzionet e Avokatit të Popullit të RMV-së në këtë raport sugjerojnë se institucioni nuk ka dhënë të drejtën e privatësisë, duke pasur parasysh se fëmijët e gjinive të ndryshme akomodohen në hapësira që janë afër njëra tjetrës dhe ndahen vetëm nga një korridor, ndërsa dyert e dhomave të tyre nuk kanë çelësa. Aq më tepër, fëmijët ndanin të njëjtin oborr me persona të pastrehë, të cilët po ashtu ishin strehuar në pjesë të ndryshme të këtij institucioni, ndërsa fëmijët kanë pasur kontakte të

përditshme me ata, gjë që konsiderohet si pengesë për procesin e risocializimit të tyre. Edhe shkalla e higjienës në këtë institucion perceptohet si shumë e ulët. Konkluzioni i përgjithshëm i raportit është se ky institucion nuk ka përmbushur standardet për përkujdesjen ndaj fëmijëve në rrezik dhe me probleme me sjelljen e tyre. Andaj, një hap shumë pozitiv përpara është mbyllja e këtij institucioni dhe procesi i deinstitutionalizimit të këtyre fëmijëve, dhe vendosja e tyre në forma alternative të kujdesit. Ndërkaq, objekti edukativo-korrektues i sapondërtuar në Vollkovija është hapur në nëntor të vitit 2020.

Duke marrë parasysh problemet e përmendura më sipër, procesi i deinstitutionalizimit është shumë i rëndësishëm sa herë që mund të zbatohet, si në rastin kur fëmijët nga shtëpitë kujdestare vendosen në forma alternative të kujdesit. Megjithatë, kjo nuk zgjidh tërësisht problemin e institucioneve ku fëmijët në konflikt me ligjin duhet të vuajnë dënimin me burgim. Një reformë e thellë e këtyre institucioneve dhe investimet serioze buxhetore mbeten të jenë kritike për të parashikuar një risocializim dhe riintegrim të duhur të këtyre fëmijëve.

Në lidhje me procesin në vazhdim të deinstitutionalizimit, Raporti i UNICEF-it i vitit 2019 për mirëqenien dhe të drejtat e adoleshentëve në kujdestari tregon se ky proces ka kontribuar në rritjen e vazhdueshme të numrit të fëmijëve të vendosur në forma alternative të kujdesit. Si rezultat i kësaj, shumica e institucioneve po mbyllen dhe një numër i kufizuar i fëmijëve mbetet në kujdes institucional. Numri i shtëpive të grupeve të vogla (SHGV) po rritet vazhdimisht. Në tetor 2019, ka pasur 20 SHGV me gjithsej 98 fëmijë të vendosur në to. Gjysma e SHGV-ve janë në Shkup, kurse dhjetë të tjerat janë në Berovë, Kavadar, Shtip, Manastir, Timjanik dhe Negotinë. Numri i përgjithshëm i fëmijëve të vendosur në llojet alternative të kujdesit arriti 320 në mars 2019. Nga ato, 285 ishin adoleshentë, gjegjësisht të moshës 10 deri 19 vjeç, ku një e treta, apo 79 ishin romë.

Strategji të rëndësishme për mbrojtjen e fëmijëve në RMV janë: Strategjia Kombëtare (2020-2025) dhe Plani i Veprimit (2020-2022) mbi Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Dhunës dhe Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Delikucencës së të Miturve (2010-2020). I pari është një dokument i ri i hartuar dhe i publikuar në 2020, ndërsa ky i fundit tani është një dokument i vjetruar dhe nevojitet një strategji e re kombëtare për parandalimin e delikucencës së fëmijëve, që do të pasqyrojë ndryshimet në Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët dhe terminologjinë e tij të re në lidhje me fëmijët në rrezik, fëmijët në konflikt me ligjin dhe fëmijët

¹¹ Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikucencës së të Miturve. Raportet 2018 -2020, Të disponueshme në: <http://dspdp.com.mk/category/dokumenti/izvestai/> [Qasur më 16 shtator, 2021].

¹² Instituti i Veprimtarive Sociale, Shkup, Raporti Vjetor për vitin 2020, i disponueshëm në: <http://zsd.gov.mk/wp-content/uploads/2021/03/%D0%98%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98-%D0%B7%D0%B0-%D1%80%D0%B0%D0%B1%D0%BE%D1%82%D0%B0-2020-3.pdf> [Qasur më 12 shtator, 2021].

viktima. Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Dhunës është një dokument i rëndësishëm që synon mbrojtjen e fëmijëve nga format e ndryshme të dhunës. Shqyrton abuzimin dhe shpërfilljen e fëmijëve, abuzimin fizik, ndëshkimin trupor, abuzimin emocional dhe psikologjik, neglizhencën, dhunën në familje, eksploatimin, dhunën mes moshatarëve, dhunën nga partneri intim dhe dhunën me bazë gjinore. Kjo strategji, edhe pse kryesisht e përqendruar në mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna e jo në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në përgjithësi, paraqet një hap të rëndësishëm përpara në procesin e mbrojtjes së fëmijëve, siç sugjerohet në rekomandimet e raporteve të UNICEF-it, të tilla si Analiza e Gjendjes së Grave dhe Fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, UNICEF, Maqedonia e Veriut, 2020.

Një aspekt i rëndësishëm i mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe parandalimit të delikuencës së fëmijëve u ngrit gjatë kohës së Pandemisë Covid-19, e cila ndikoi në thelb mirëqenien e fëmijëve në nivelin global si dhe zbatimin e të drejtave të tyre themelore si e drejta e arsimit. Raporti “Efektet sociale dhe ekonomike të COVID-19 tek fëmijët në Maqedoninë e Veriut: një përditësim trajton reagimin e qeverisë ndaj Covid-19 dhe efektin e tij mbi fëmijët, mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve gjatë pandemisë Covid-19, ndikimin e pandemisë mbi varfërinë tek fëmijët, procesin arsimor gjatë pandemisë si dhe rreziqet shëndetësore nga Covid-19 për fëmijët. Raporti analizon ricaktimin e buxhetit në lidhje me pandeminë dhe sugjeron se rritja e nevojave financiare në tre sektorët lidhur me fëmijët – arsimi, shëndetësia dhe mbrojtja sociale – do të përballen me një hapësirë të kufizuar dhe tkurrje fiskale, si dhe me presionin e borxhit publik. Vendosija e objektivave të shpenzimeve në fushat kyçe që lidhen me fëmijët për vitet e ardhshme mund të ndihmojë planifikimin afatmesëm dhe zbutjen e efekteve të pafavorshme ndaj fëmijëve, të imponuara nga kriza COVID-19.

Sa i përket buxhetit për zbatimin e legjisllacionit mbi parandalimin e delikuencës së fëmijëve, duke analizuar dokumentet e lartpërmendura mund të konkludohet se shteti nuk investon mjete të mjaftueshme për zbatimin e kësaj pjese të legjisllacionit. Duke pasur parasysh se drejtësia për fëmijët është pjesë e zbatimit të përgjithshëm të drejtësisë brenda shtetit, mund të konkludohet se RNM-ja duhet të rrisë buxhetin i cili investohet në institucionet shtetërore të specializuara për administrimin e drejtësisë. Çështja e shpenzimeve aktuale për drejtësinë për fëmijët nga qeveria trajtohet në pjesën 3 të analizës.

Metodologjia

U zhvillua një metodologji gjithëpërfshirëse për qëllimet e adresimit të çështjeve në fjalë. Metodologjia kombinon dy segmente: (1) shqyrtimin gjithëpërfshirës në zyrë dhe (2) kërkimin e të dhënave parësore.

Rishikimi gjithëpërfshirës në zyrë u bazua tek identifikimi dhe analiza e një numri burimesh relevante duke përfshirë: legjislacionin ndërkombëtar dhe kombëtar, raportet, strategjitë dhe dokumentet shtesë. Qëllimi i rishikimit ishte të eksploronte mjedisin ekzistues kombëtar për drejtësinë për fëmijët, veçanërisht në lidhje me buxhetin e qeverisë në fushën e drejtësisë për fëmijët në Maqedoninë e Veriut, si dhe të identifikonte të gjithë vepruesit përkatës në këtë sektor. Më tej, qëllimi i kësaj pjese të hulumtimit në zyrë ishte përcaktimi i strukturës në sistemin e institucioneve përkatëse, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre ekzistuese, si dhe nevojën për përshtatje të mëtejshme të legjislacionit kombëtar në lidhje me detyrimet ndërkombëtare të vendit. Më anë të analizës u identifikuan pikat relevante kryesore dhe u shqyrtuan më tej gjatë fazës së kërkimit parësor. Ky segment i hulumtimit u realizua në periudhën qershor – korrik 2021. Dokumentet e mëposhtme u përfshinë në fazën e rishikimit në zyrë:

Dokumentet ndërkombëtare (sipas rendit alfabetik)

- ▲ Këshilli i Evropës R(87)20 në lidhje me reagimin social ndaj delikuencës së të miturve, 1987;
- ▲ Këshilli i Evropës R(88)6 në lidhje me reagimet sociale ndaj delikuencës së të miturve në mesin e njerëzve të rinj që vijnë nga familje migrante, 1988;
- ▲ Këshilli i Evropës R(2003)20 në lidhje me mënyrat e reja të trajtimit të delikuencës së të miturve, 2003;
- ▲ DIREKTIVA (EU) 2016/800 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE KËSHILLIT e 11 majit 2016 mbi masat mbrojtëse procedurale për fëmijët që janë persona të dyshuar ose të akuzuar në procedurë penale;
- ▲ Rezoluta ECOSOC 2005/20 Udhëzues Drejtësie në çështjet që përfshijnë fëmijë viktime dhe dëshmitarë të krimit;
- ▲ Udhëzimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve, 2010;
- ▲ Udhëzimet e KB-ve për veprim në lidhje me fëmijët në sistemin e drejtësisë penale;
- ▲ Udhëzimet e KB-ve për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve (Rregullat e Riadit);
- ▲ Rregullat e KB-ve për mbrojtjen e të miturve të privuar nga liria (Rregullat e Havanës);
- ▲ Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës;
- ▲ Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit (“Rregullat e Pekinit”);
- ▲ Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.

Legjislacioni kombëtar

- ▲ Ligji i Llogaritjes së Buxhetit dhe Shfrytëzuesve Buxhetorë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 61/2002, 98/2002, 81/2005, 24/2011, 145/2015 dhe 170/2017);
- ▲ Ligji i Buxhetit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 64/2005; 4/2008; 103/2008; 156/2009; 95/2010; 180/2011; 171/2012; 192/2015 dhe 116);
- ▲ Ligji i Zbatimit të Sanksioneve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 99/2019 dhe 220/2019);
- ▲ Ligji i Familjes (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 80/1992, 9/1996, 38/2004, 33/2006, 84/2008, 67/2010, 156/2010, 39/2012, 44/2012/2014, 115/2014, 104/2015 dhe 150/2015 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 53/2021);
- ▲ Ligji i Ndhmës Juridike Falas (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 101/2019);
- ▲ Ligji i Drejtësisë për Fëmijët (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 148/2013 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 152/2019 dhe 275/2019);
- ▲ Ligji i Ndërmjetësimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 188/2013, 148/2015, 192/2015 dhe 55/2016)
- ▲ Ligji i Mbrojtjes së Fëmijëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Veriut nr. 101/2019);

së Maqedonisë së Veriut nr. 121/18, 198/18, 104/2019, 146/19, 275/19) dhe

- ▲ Ligji i Mbrojtjes Sociale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 104/2019, 146/2019, 275/2019, 302/2020 dhe 311/2020).

Raportet

- ▲ Raporti Vjetor i Këshillit Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve (2018 -2020);
- ▲ Raporti Vjetor i Institutit të Veprimtarive Sociale (2018-2020);
- ▲ Raporti Vjetor i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut (2018 - 2020);
- ▲ Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (2018 - 2020);
- ▲ Raportet vjetore mbi shkallën e sigurimit, respektimit, avancimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut (Avokati i Popullit, 2018-2020) dhe
- ▲ Raporti i vizitës së Institucionit Publik të Institutit të Kujdesit, Rritjes dhe Arsimimit të Fëmijëve dhe të Rinjve “Ranka Millanoviç” (2019)¹³.

Strategjitë dhe dokumentet e tjera të programit

- ▲ Plani i Veprimit mbi Punësimin e Njerëzve të Rinj (2016-2020);
- ▲ Treguesit për monitorimin dhe zbatimin e Ligjit të Drejtësisë për Fëmijët;
- ▲ Programi Kombëtar për Zhvillimin e Mbrojtjes Sociale (2011-2021), Ministria e Punës dhe Politikës Sociale;
- ▲ Strategjia Kombëtare (2020 - 2025) dhe Plani i Veprimit (2020 - 2022) mbi Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna;
- ▲ Strategjia Kombëtare mbi Parandalimin e Delikuencës së të Miturve (2010-2020);
- ▲ Strategjia Kombëtare për Rininë (2016-2025), Agjencia e Rinisë dhe Sportit;
- ▲ Plani Operacional për Zbatimin e Strategjisë

Kombëtare për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve (2015-2017);

- ▲ Raporti i Veçantë mbi gjendjen dhe kushtet për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve pa prindër dhe kujdes prindëror të vendosur në një institucion publik të kujdesit në Republikën e Maqedonisë (Avokati i Popullit, 2017);
- ▲ Strategjia e Arsimit (2018-2015), Ministria e Arsimit;
- ▲ Strategjia Kombëtare e Deinstitutionalizimit në Republikën e Maqedonisë 2018-2027 “Timjanik”, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale;
- ▲ Raporti i gjendjes në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shpërfillja në pajtim me treguesit e krijuar në 2017, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve - Kavadar, 2019.

Gjetjet dhe konkluzionet e segmentit të rishikimit në zyrë janë përdorur për të hartuar metodologjinë specifike për hulumtimin e të dhënave parësore në lidhje me buxhetin e qeverisë në fushën e drejtësisë për fëmijët në Maqedoninë e Veriut. Kërkimi i të dhënave parësore ka kombinuar dy elemente kyçe: (i) përgatitjen, dërgimin dhe analizimin e kërkesave për qasje të lirë në informacione me karakter publik, dhe (ii) faza e intervistave me palët kryesore të interesit.

Në bazë të fazës së shqyrtimit të kryer në zyrë, janë përgatitur kërkesat e personalizuara për qasje të lirë në informacione me karakter publik, ndërsa 168 kërkesa për qasje të lirë në informacione me karakter publik janë dorëzuar tek institucionet kompetente në nivel kombëtar dhe lokal (bartësit e informacioneve me karakter publik). Janë pranuar 108 përgjigje ndaj kërkesave deri në afatin e fundit të përcaktuar me Ligjin e Qasjes së Lirë në Informacione me Karakter Publik. Si rezultat i kësaj, në Agjencinë për mbrojtjen e së drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik janë dorëzuar 60 ankesa. Pas procedurës së ankimimit, janë dorëzuar edhe 54 përgjigje zyrtare nga institucionet e synuara. Gjithsej 6 institucione nuk kanë dërguar përgjigje zyrtare pas vendimit të Agjencisë.¹⁴ Në koordinim me donatorin është marrë vendimi që mos të zhvillohet procedura gjyqësore ndaj institucioneve të lartpërmendura.

Mbledhja dhe analiza e të dhënave parësore është kryer në periudhën gusht – nëntor 2021. Kërkesat

¹³ Ky institucioni tanimë është mbyllur me procesin e deinstitutionalizimit dhe fëmijët tanimë janë vendosur në shtëpi grupore të vogla.

¹⁴ Këto institucione janë: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Komunitat e Gazi Babës, Gostivarit, Likovës dhe Tearcës.

janë përgatitur në përputhje me Ligjin e Qasjes së Lirë në Informacione me Karakter Publik dhe në bazë të të gjitha burimeve të identifikuar. U zhvillua një qasje e veçantë e personalizuar në çdo kategori të 168 institucioneve të identifikuar. Një pyetësor i veçantë për secilën kategori (ministri të ndryshme, komuna, gjykata, prokurori publike, autoritete dhe organe të veçanta shtetërore) është përgatitur nga ekipi i ekspertëve në bazë të burimeve të analizuar gjatë fazës së shqyrtimit në zyrë. Përveç pyetësorëve të zhvilluar, nga të gjitha institucionet e synuara është kërkuar që të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesa buxhetore në përputhje me Ligjin e Buxheteve e institucioneve të numëruara në Tabelën 1 (2018-2020);
2. Plani i Prokurimit Publik të institucioneve të numëruara në Tabelën 1 (2018-2020);
3. Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut (2018-2020);
4. Buxheti i njësisë të vetëqeverisjes që kanë vendosur këshilla komunalë për parandalimin e delikucencës së fëmijëve (2018-2020);
5. Llogaritë vjetore të institucioneve të treguara në Tabelën 1 (2018-2020);
6. Hapja e bazës së të dhënave të financave të Ministrisë së Financave;
7. Prokurimet Publike të përfunduara në institucionet e numëruara në Tabelën 1 (2018-2020) dhe
8. Akti për sistematizimin në fuqi në tri vitet e fundit.

Dokumentet e renditura në pikat 1 dhe 2 janë përdorur për të analizuar procedurat e planifikimit për zbatimin e Ligjit të Drejtësisë për Fëmijët dhe akteve legjislative që kanë të bëjnë me këtë ligj (Ligji i Mbrojtjes së Fëmijëve, Ligji i Mbrojtjes Sociale dhe Ligji i Zbatimit të Sanksioneve) në institucionet e synuara dhe t'i krahasojnë ato me caktimin aktual të miratuar të financimit të deklaruar në dokumentet e renditura në pikat 3 dhe 4. Në bazë të dokumenteve të renditura në pikat 5 dhe 6, ekipi hulumtues ka vlerësuar shpenzimin aktual të fondeve publike për zbatimin e Ligjit të Drejtësisë së Fëmijëve. Veç kësaj, zërat e mbetur janë përdorur për të vlerësuar kapacitetet e institucioneve të synuara.

Dokumentet e lartpërmendura dhe përgjigjet në pyetësorët përfaqësonin burimet kryesore për analizën e shpenzimeve të buxhetit të qeverisë në fushën e drejtësisë për fëmijët në Maqedoninë e

Veriut.¹⁵ Analiza e shpenzimeve u përqendrua në tri vitet fiskale (2018, 2019 dhe 2020). Objektivi i analizës së shpenzimeve ishin institucionet e identifikuar në Tabelën 1. Analiza e shpenzimeve mbështetet edhe mbi informacionet e disponueshme publike të publikuara në faqet e internetit institucionale dhe faqet e Byrosë së Prokurimit Publik dhe Ministrisë së Financave për kontroll të dyfishtë të të dhënave. Për më tepër, të dhënat statistikore në dispozicion të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikave si dhe raportet e Entit Shtetëror të Auditimit janë shfrytëzuar për qëllimet e analizës.

Elementi i dytë i hulumtimit të të dhënave parësore ishte organizimi i intervistave me palët e interesuara përkatëse. Duke qenë se anketat e kryera me telefon ose e-mail kanë përqindje më të ulët reagimi, mundësi më të madhe për keqkuptime dhe cilësi më të ulët të rezultateve, në periudhën tetor-nëntor 2021 u zhvilluan një sërë intervistash online me anëtarë të lartë të institucioneve.

Intervistat kishin si bazë një pyetësor gjysmë të strukturuar (të rregulluar në konsultim me donatorin) me 10 përfaqësues përkatës të institucioneve të synuara duke u përpjekur të adresojnë paqartësitë, mospërputhjet e mundshme dhe të mbledhin informacione që nuk do të mund të mblidheshin me anë të kërkesave për qasje të lirë në informacione me karakter publik. U aplikua modeli i krahasimit të modeleve dhe u përfshinë përfaqësues të segmenteve të ndryshme (përfaqësues të ministrisë, punonjës socialë, përfaqësues të dhomës si dhe zyra financiare në palët e përzgjedhura të interesit). Vëmendje e veçantë i është kushtuar të siguruarit që të anketuarit e synuar janë individë nga menaxhmenti i lartë të cilët janë ose përgjegjës ose të autorizuar për shprehjen e pikëpamjes së institucionit për çështjet në fjalë. Gjetjet nga intervistat janë përfshirë në analizë.

Të gjithë vepruesit përkatës në parandalimin parësor, dytësor dhe terciar të përfshirë në Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Delikucencës së të Miturve (2010 -2020) dhe Planin Operacional (2015-2017) janë identifikuar në Tabelën 1. Kompetencat e autoriteteve të ndryshme në sistemin e drejtësisë për fëmijët janë shtjelluar në Aneksin 1 të dokumentit.

¹⁵ Analiza e pyetjeve të sugjeruara kërkimore varej nga marrja e informacioneve përkatëse, të plota dhe të sakta nga autoritetet kombëtare në përputhje me legjislacionin për qasje të lirë në informacione me karakter publik. IKSE-ja ka zbatuar metodologjinë e propozuar duke përfshirë të drejtën për t'u ankuar tek autoriteti kompetent, por nuk është në gjendje të marrë informacione jashtë kornizës së sugjeruar të kërkimit. Përgjigjet e pyetjeve të kërkimit varen nga cilësia dhe sasia e informacioneve të paraqitura nga autoritetet kombëtare të synuara në përputhje me Ligjin.

Tabela nr. 2 - Vepruesit kombëtarë dhe autoritetet kompetente në fushën e drejtësisë për fëmijët në Maqedoninë e Veriut

Institucioni*
Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publik “Pavell Shatev”
Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale
Agjencia për Rini dhe Sport
Dhoma e Avokatisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Byroja për Zhvillimin e Arsimit
Qendra për Arsimimin e të Rriturve
Qendrat për Punë Sociale
Dhoma e Ndërmjetësuesve
Gjykatat (me juridiksion të zgjeruar)
Drejtoria për Zbatimin e Sanksioneve
Institucioni Edukativo-Korrektues Tetovë
Fakulteti i Sigurisë Shkup (UKLO)
Burgjet (Idrizovë dhe Ohër)
Institucioni Publik për përkujdesje ndaj fëmijëve me probleme arsimore dhe sociale dhe me sjellje të dëmtuar
Instituti i Veprimtarive Sociale
Burgu i të Miturve Ohër
Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Ministria e Shëndetësisë
Ministria e Punëve të Brendshme
Ministria e Drejtësisë
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
Trupi Koordinues Kombëtar për parandalimin e abuzimit dhe neglizhencës
Avokati i Popullit
Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve
Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale, duke përfshirë dhe këshillat lokalë

Vizualizimi - 9 hapa për procedurën e planifikimit të buxhetit - të përgatitet nga një projektuesi profesionist

Hapi 1 - Plani strategjik në nivelin kombëtar
Hapi 2 - Plani strategjik i shfrytëzuesve buxhetorë
Hapi 3 - Strategjia fiskale
Hapi 4 - Qarkorja buxhetore
Hapi 5 - Hartimi dhe dorëzimi i planit të programit zhvillimor
Hapi 6 - Dorëzimi i kërkesave buxhetore
Hapi 7 - Rregullimi i kërkesave buxhetore
Hapi 8 - Hartimi i propozimit buxhetor
Hapi 9 - Dorëzimi i buxhetit

Rezultatet (shpenzimet publike dhe trendët)

Kjo pjesë e raportit paraqet gjetjet kryesore të të dhënave të analizuar që janë paraqitur nga institucionet në përgjigjet e kërkesave për qasje të lirë në informacione me karakter publik. Duke pasur parasysh shumëllojshmërinë e informacioneve të paraqitura në përgjigjet e institucioneve, gjetjet e analizës janë paraqitur në nivelin institucional dhe sipas renditjes alfabetike. Në bazë të kërimit kompleks që u zbatua (u identifikuan 168 institucione të ndryshme), u mbledhën vetëm informacione të pjesëshme mbi shpenzimet specifike për disa institucione. Disa institucione me relevancë të lartë nuk dorëzuan përgjigje zyrtare, edhe pse është ngritur një procedurë ankimore. Disa nga institucionet nuk janë në dijeni për përgjegjësitë në sistem, ndërsa disa nga institucionet dorëzuan përgjigje të pjesëshme ose jo të plota. Në disa raste u identifikua një mospërputhje mes informacioneve të paraqitura në përgjigjet zyrtare dhe në raportet financiare zyrtare, në bilancet etj. Në fund të analizës do të prezantohen konkluzionet e përgjithshme.

Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë “Pavell Shatev”

Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë “Pavell Shatev” ofron trajnime që përfshijnë fushën e drejtësisë për fëmijët gjatë tërë vitit. Akademia ka dhënë informacione mbi numrin e pjesëmarrësve në trajnimet e zhvilluara. Gjithsej 162 pjesëmarrës kanë ndjekur trajnime në këtë temë, që janë organizuar në periudhën 2018-2020.

Tabela 3 - Profili i pjesëmarrësve në trajnimet për drejtësi për fëmijët, të organizuara nga Akademia

Viti	Profili i pjesëmarrësve në trajnimet për drejtësi për fëmijët, të organizuara nga Akademia			
	Gjykatës	Prokurorë Publikë	Bashkëpunëtorë	Të tjerë
2018	44	40	26	15
2019	8	12	2	15
2020	0	0	0	0

Në anën tjetër, Akademia nuk ka dorëzuar informacione për fondet e planifikuara dhe shpenzuara për realizimin e trajnimeve në fushën e drejtësisë për fëmijë. Aktet e brendshme për shpenzimet e buxhetuara që kanë të bëjnë me drejtësinë për fëmijët nuk janë miratuar. Institucioni mban një llogari dhe evidencë të veçantë për donacionet dhe zakonisht nuk merr pjesë në financim me asetet e veta në aktivitetet e financuara nga donacionet.¹⁶

¹⁶ Informacionet e dhëna në bazë të kërkesës për qasje të lirë në informacione me karakter publik të dorëzuar më 18 gusht 2021 dhe ankesës së dorëzuar më 17 shtator 2021.

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audio-Vizuale nuk realizon aktivitete të drejtpërdrejta dhe as nuk ka shpenzime që kanë të bëjnë me Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët. Megjithatë, Agjencia zbaton monitorim për parandalimin e fëmijëve nga përbërjet e dëmshme në media.¹⁷

Agjencia për Rini dhe Sport

Agjencia për Rini dhe Sport përfaqëson një autoritet kompetent për të rinjtë të moshës 15-29 vjeç. Agjencia nuk zbaton aktivitete që kanë të bëjnë me fëmijët dhe Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët.¹⁸

Dhoma e Avokatisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Dhoma e Avokatisë nuk ka organizuar trajnime e as nuk ka shpenzuar fonde për zbatimin e Ligjit të Drejtësisë për Fëmijët. Veç kësaj, Dhoma e Avokatisë nuk ka shfrytëzuar fonde nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, e as nga donacione.

Veç kësaj, Dhoma e Avokatisë ka bërë të ditur bashkëpunimin me Ministrinë e Drejtësisë dhe aspektet operative të ndihmës juridike falas. Gjithashtu, është evidentuar nevoja për themelimin e një qendre trajnimi në kuadër të Dhomës së Avokatisë me qëllim ofrimi i trajnimeve specifike duke përfshirë edhe çështjet e drejtësisë për fëmijët.¹⁹

¹⁷ Informacionet e dhëna me bazë kërkesën për qasje të lirë në informacione me karakter publik, të dorëzuara më 18 gusht 2021.

¹⁸ Informacionet e dhëna në bazë të kërkesës për qasje të lirë në informacione me karakter publik të dorëzuar më 18 gusht 2021 dhe ankesës së dorëzuar më 17 shtator 2021.

¹⁹ Informacionet e dhëna në bazë të kërkesës për qasje të lirë në informacione me karakter publik të dorëzuar më 18 gusht 2021 dhe ankesës së dorëzuar më 17 shtator 2021, dhe intervistës së zbatuar.

Byroja për Zhvillimin e Arsimit

Byroja për Zhvillimin e Arsimit nuk ka realizuar dhe as nuk i janë ndarë fonde për asnjë aktivitet që ka të bëjë me zbatimin e Ligjit të Drejtësisë për Fëmijë apo Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Delikucës së të Miturve në periudhën 2018-2020.²⁰

Qendra për Arsimimin e të Rriturve

Qendra për Arsimimin e të Rriturve nuk ka realizuar asnjë aktivitet lidhur me Planin Operacional për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Delikucës së Fëmijëve.²¹

Qendrat për Punë Sociale

Pothuajse të gjitha qendrat për punë sociale kanë dorëzuar informacione të kufizuara mbi aspektet financiare të punës së tyre të përditshme. Në këtë drejtim, pothuajse të gjitha qendrat kanë treguar se nuk kanë kërkuar, e as nuk kanë marrë fonde për asistencë dhe mbrojtje të fëmijëve në konflikt me ligjin, fëmijëve viktime dhe fëmijëve në kontakt me ligjin, konform Ligjit të Drejtësisë për Fëmijët. Gjithashtu, qendrat kanë treguar se nuk kanë kërkuar financim për ekipe profesionale për punë me fëmijët, punë individuale dhe organizim të trajnimeve. Më tej, sipas qendrave, nuk është kërkuar financim nga ana e tyre për masat e mbikëqyrjes së shtuar dhe dënimit me

kusht me mbikëqyrje mbrojtëse. Gjithashtu, nuk është kërkuar financim për zhvillimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit.

Nga ana tjetër, Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale - Shkup (QNPS) ka prezantuar informacione konkrete mbi shpenzimet për asistencë dhe mbrojtje të fëmijëve në konflikt me ligjin, fëmijëve viktime dhe fëmijëve në kontakt me ligjin, konform Ligjit të Drejtësisë për Fëmijët. Në bazë të informacioneve të dorëzuara nga QNPS-ja, gjithsej 1.957.448,00 denarë janë shpenzuar në vitin 2018; 2.361.582,00 denarë në vitin 2019 dhe 3.052.407,00 denarë në vitin 2020.

Ndërkaq, janë dorëzuar informacione mbi shpenzimet për pagat e ekipit profesionist që punon me fëmijë - 5.916.244,00 denarë në vitin 2018; 4.442.619,00 denarë në vitin 2019 dhe 4.993.741,00 në vitin 2020. Kur këto kosto vihen në përpjesëtim me numrin e fëmijëve të përfshirë çdo vit, mund të përfitohet kostoja e realizuar për fëmijë në kategoritë e asistencës dhe mbrojtjes së fëmijëve në konflikt me ligjin, fëmijëve viktime dhe fëmijëve në kontakt me ligjin, konform Ligjit të Drejtësisë për Fëmijët. Këto të dhëna prezantohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 4 - Pasqyrë e shpenzimeve për fëmijë - Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale – Shkup (2018-2020)

(në denarë)

	2018	2019	2020
Shpenzimet për asistencë dhe mbrojtje të fëmijëve në konflikt me ligjin, fëmijëve viktime dhe fëmijëve në kontakt me ligjin	1.957.448	2.361.582	3.052.407
Pagat e ekipit profesionist që punon me fëmijë në konflikt me ligjin, fëmijë viktime dhe fëmijë në kontakt me ligjin	5.916.244	4.442.619	4.993.741
Gjithsej shpenzimet për asistencë dhe mbrojtje të fëmijëve në konflikt me ligjin, fëmijëve viktime dhe fëmijëve në kontakt me ligjin	7.873.692	6.804.201	8046148
Numri i fëmijëve të përfshirë	75	138	209
Kostot për fëmijë	104.983	49.306	38.498

²⁰ Informacionet e dhëna me bazë kërkesën për qasje të lirë në informacione me karakter publik, të dorëzuara më 18 gusht 2021.

²¹ Informacionet e dhëna me bazë kërkesën për qasje të lirë në informacione me karakter publik, të dorëzuara më 18 gusht 2021.


Analiza sugjeron se kostot për fëmijë në QNPS – Shkup janë në rënie nga viti në vit, ku më shumë se gjysma janë ulur në vitin 2019, krahasuar me vitin 2018. Është kjo rezultat e numrit të shtuar të fëmijëve në konflikt me ligjin, fëmijëve viktime dhe fëmijëve në kontakt me ligjin të përfshirë. Fondet e shpenzuara për këtë qëllim janë rritur pak, por nuk janë rritur në të njëjtin raport me rritjen e numrit të fëmijëve të përfshirë.

Fondet e shpenzuara për asistencë dhe mbrojtje të fëmijëve në konflikt me ligjin, fëmijëve viktime dhe fëmijëve në kontakt me ligjin janë realizuar përmes nënzërave të mëposhtme të buxhetit:

- ▲ 471290 Vendosja në institucione për fëmijë pa prindër dhe kujdes prindëror,
- ▲ 423410 Ushqime dhe pije dhe
- ▲ 421110 Elektricitet.

Sa u përket mjeteve të kërkuara në nivel mujor nga QNPS – Shkup nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, të cilat janë 320.200 denarë në muaj në vitin 2019 dhe 412.200 MKD në muaj në vitin 2020, mund të konstatohet se janë dukshëm më të larta në raport me fondet e miratuara për shpenzim nga Ministria kompetente, e të cilat mund të shihen në grafikun e mëposhtëm. Megjithatë, mund të konstatohet se në vitin 2020 janë miratuar dhe shpenzuar më shumë fonde për asistencë dhe mbrojtje të fëmijëve në konflikt me ligjin, fëmijëve viktime dhe fëmijëve në kontakt me ligjin në krahasim me vitin 2019, që sigurisht është një ndryshim pozitiv, aq më tepër që ai është një vit jo tipik.


Grafiku 1 – Mjetet e kërkuara kundrejt aprovimit nga MPPS-ja për QNPS-në Shkup



Qendrat e tjera për Punë Sociale në vend nuk kanë ofruar të dhëna për fondet e kërkuara dhe të miratuara për asistencën dhe mbrojtjen e fëmijëve në konflikt me ligjin, fëmijëve viktime dhe fëmijëve në kontakt me ligjin, gjë që nuk bën të mundur zhvillimin e analizave të mëtejshme. Vetëm Qendra për Punë Sociale - Tetovë ka deklaruar se paguan 190.000,00 denarë në vit për qira të lokaleve që shfrytëzon dhe Qendra për Punë Sociale - Kavadar që organizon kamp veror për ndihmë dhe mbrojtje të fëmijëve në konflikt me ligjin, fëmijëve viktime dhe fëmijëve në kontakt me ligjin, i cili financohet tërësisht nga donacione në vlerë prej 1.955.206,00 denarë në vitin 2018; 2.149.110,00 denarë në vitin 2019 dhe 3.856.655,00 denarë në vitin 2020.

Për sa u përket shërbimeve të ofruara nga qendrat për punë sociale për mbrojtjen e fëmijëve, në bazë të informacioneve të paraqitura në raportet vjetore për punën e tyre, janë siguruar të dhëna përkatëse për profilin e rasteve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve. Të dhënat e përmbledhura për këtë analizë janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm. Grupi i fëmijëve me interes të veçantë në këtë studim janë fëmijët në rrezik dhe fëmijët në konflikt me ligjin. Edhe nga të dhënat e marra mund të konstatohet se ka pasur një rritje të ndjeshme të rasteve të trajtuara nga qendrat për punë sociale për fëmijët në rrezik në vitin 2019, dhe në lidhje me rastet e fëmijëve në konflikt me ligjin ka një rënie të lehtë nga viti në vit.

Grafiku 2 - Mbrojtja e fëmijëve



Disa qendra për punë sociale kanë dorëzuar të dhëna mbi numrin e fëmijëve me të cilët kanë punuar sipas Ligjit të Drejtësisë për Fëmijët dhe të dhëna mbi të ardhurat sipas viteve. Si rezultat i kësaj, është bërë një analizë e përqindjes së rasteve me fëmijë që kanë të bëjnë me Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët të çdo qendre në raport me numrin e përgjithshëm të rasteve nga të gjitha qendrat, si dhe përqindjen e të hyrave të secilës qendër në raport me të ardhurat totale të këtyre qendrave. Kjo analizë është paraqitur në tabelën e mëposhtme:


Nga 15 QPS-të e analizuara mund të konkludohet se 10 QPS marrin pjesë me një përqindje më të ulët të fëmijëve të përfshirë në krahasim me përqindjen me të cilën ata marrin pjesë në të ardhurat totale. Vetëm 5 QPS kanë përqindje më të lartë të pjesëmarrjes së fëmijëve të përfshirë në raport me pjesëmarrjen në të hyrat totale. Fatkeqësisht, për shkak të të dhënave të kufizuara dhe mungesës së informacioneve të tjera kyçe, nuk mund të kryheshin analiza të tjera të thelluara të efikasitetit të qendrave për punë sociale apo llogaritje më të detajuara të kostove të realizuara për fëmijë.

Tabela nr. 5 – Përqindja e rasteve dhe të ardhurave për qendër

QPS	Numri i fëmijëve			Të ardhurat		
	2018	2019	2020	2018	2019	2020
Kërçovë	1.3%	2.9%	1.2%	4.4%	3.9%	6.1%
Kratovë	1.4%	0.4%	0.1%	2.4%	2.4%	3.6%
Prilep	6.9%	8.3%	7.9%	6.0%	5.7%	10.4%
Shkup	7.4%	12.4%	14.4%	36.4%	37.7%	0.0%
Manastir	21.2%	20.2%	9.5%	8.0%	7.3%	12.9%
Kavadar	10.5%	12.0%	12.6%	5.0%	5.1%	9.3%
Veles	20.7%	16.7%	16.2%	7.5%	7.5%	12.6%
Negotinë	10.3%	10.5%	10.6%	2.9%	3.0%	0.0%
Kriva Pallankë	0.5%	0.3%	0.3%	3.4%	3.6%	6.2%
Berovë	1.1%	1.5%	1.5%	5.4%	5.0%	7.4%
Strumicë	4.3%	4.4%	18.1%	5.0%	5.3%	9.7%
Resnje	0.3%	0.6%	0.8%	2.6%	2.4%	3.9%
Dellçevë	2.2%	1.3%	0.4%	3.7%	3.9%	6.5%
Dibër	0.9%	1.4%	1.0%	3.4%	3.4%	4.8%
Ohër	11.2%	7.0%	5.3%	4.1%	3.9%	6.4%
GJITHSEJ	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Duke pasur parasysh të dhënat e mbledhura për 15 QPS, vërehet se numri i fëmijëve të përfshirë në vitin 2019, krahasuar me vitin 2018 është rritur për 9% dhe të hyrat janë rritur për 19%, ndërsa numri i fëmijëve të përfshirë në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 është rritur për 30%, dhe janë rritur edhe të ardhurat për 19% (Grafiku më poshtë). Rrjedhimisht, vërehet një trend pozitiv i rritjes së të hyrave të QPS-ve nga viti në vit, në të dyja vitet për 19%, ndërsa përfshirja e fëmijëve po ashtu rritet nga viti në vit. Megjithatë në vitin 2019 ajo përqindje e rritjes është më e ulët në raport me rritjen e të ardhurave dhe në vitin 2020 ritmi i rritjes së fëmijëve të përfshirë është më i lartë në raport me rritjen e të ardhurave në po të njëjtin vit.

Grafiku nr. 3 - Përfshirja e fëmijëve dhe rritja e të ardhurave (në %)



Sa u përket aktiviteteve prioritare të QPS-ve lidhur me Ligjin e Drejtësisë për Fëmijë, qendrat të cilat kanë dhënë përgjigje konkrete lidhur me këtë çështje kanë sugjeruar si vijon:

- ▲ Aktivitete parandaluese (organizimi i diskutimeve publike dhe prezantimeve për parandalimin e delikucencës së fëmijëve);
- ▲ Ndihmë financiare të njehershme;
- ▲ Sigurimi i kompjuterëve dhe tabletave për fëmijët në rrezik dhe në konflikt me ligjin;
- ▲ Blerja e rrobave për fëmijët;
- ▲ Sigurimi i fondeve që do të përdoren për përfshirjen e fëmijëve në aktivitete sportive, vizatime, vizita në kinema dhe teatër etj.;
- ▲ Sigurimi i fondeve për rregullimin e një dhome të veçantë;
- ▲ Mjetet për zbatimin e mbikëqyrjes së shtuar dhe dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse;

- ▲ Sigurimi i fondeve për mbështetjen e ekspertëve.²²

Nuk janë dhënë informacione plotësuese në këtë kuptim nga qendrat.²³

Dhoma e Ndërmjetësuesve

As Dhoma e Ndërmjetësuesve nuk ka zbatuar aktivitete që kanë të bëjnë me fëmijët dhe Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët në periudhën 2018-2020 dhe rrjedhimisht nuk janë identifikuar kosto në këtë drejtim. Megjithatë, Dhoma është përfshirë në një projekt ndërkombëtar përmes së cilit janë ofruar shërbime ndërmjetësimi në 20 raste që kanë të bëjnë me drejtësinë për fëmijët. Pothuajse të gjitha rastet janë zgjidhur. Një nga avantazhet kryesore të ndërmjetësimit mbetet kostoja më e ulët për procedurën.²⁴

Gjykatat (me juridiksion të zgjeruar)

Gjykatat financohen përmes Këshillit Gjyqësor, kurse nuk janë ndarë fonde për financimin e delikucencës së fëmijëve në bazë të Ligjit të Drejtësisë për Fëmijët, e as deri më tani nuk kanë marrë donacione nga subjektet e brendshme apo ndërkombëtare mbi këtë bazë. Të vetmet fonde që gjykatat shpenzojnë për çështjet që lidhen me delikucencën e fëmijëve janë shpenzimet që ato i paguajnë shërbimit të mbrojtjes sipas detyrës zyrtare, shpenzimet e ekspertizës, transferimi nga dhe në një institucion të caktuar etj.

Gjithashtu, gjykatat kanë deklaruar se nuk kanë një numër të madh të lëndëve që kanë të bëjnë me Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët në nivelin vjetor. Pothuajse të gjitha gjykatat nga të cilat është marrë përgjigje, kanë deklaruar se nuk kanë një departament të posaçëm që merret me lëndët që kanë të bëjnë me Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët. Procedurat zakonisht kryhen nga këshillat ose

²² Informacione të siguruar përmes përgjigjeve të dërguara nga Qendrat për Punë Sociale në Manastir, Kërçovë dhe Kumanovë. Ndërkaq, Qendra për Punë Sociale – Shkup ka shfaqur nevojën për hapësira të reja për punëtorët e tyre, të cilat aktualisht janë të vendosura në baraka, çështje kjo që nuk lidhet drejtpërdrejt me drejtësinë për fëmijët. Qendrat e tjera për punë sociale nuk kanë dhënë përgjigje konkrete në pyetjen.

²³ Informacionet e paraqitura në këtë pjesë të analizës bazohen në informacionet e dorëzuara nga 30 qendra për punë sociale në të gjithë vendin. Përderisa 17 qendra kanë dorëzuar informacione brenda afatit të paraparë me ligj, për 13 qendra ka filluar një procedurë ankimore pas së cilës janë dhënë përgjigje zyrtare.

²⁴ Informacionet e dhëna me bazë kërkesën për qasje të lirë në informacione me karakter publik, të dorëzuara më 18 gusht 2021 dhe intervistën e zbatuar.

gjyqtarët brenda departamentit penal. Sipas Ligjit për Shërbimin Gjyqësor, nuk ka ndarje të vendeve të punës në një fushë të caktuar. Përrjashtim nga kjo janë gjykatat me juridiksion të zgjeruar ku ekziston një njësi për delikucencën e fëmijëve.

Punonjësit e gjykatave zakonisht ndjekin trajnime të organizuara nga Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë “Pavell Shatev”. Gjykatat nuk kanë miratuar asnjë akt të brendshëm që rregullon buxhetimin dhe trajtimin e çështjeve që lidhen me drejtësinë për fëmijët. Nuk është shfrytëzuar fare ndihmë nga ekspertët e jashtëm në këtë fushë.

Sipas përgjigjeve të dorëzuara nga gjykatat, vetëm tri gjykata në Maqedoninë e Veriut kanë shpalosur shumën e shpenzuar për drejtësinë për fëmijët. Gjykata në Veles ka shpenzuar 372.632,00 denarë në vitin 2018; 120.216,00 denarë në vitin 2019; dhe 3.466,00 denarë në vitin 2021 (zërat buxhetore 425310, 425320 dhe 425990). Gjykata në Strumicë ka kërkuar dhe shpenzuar 75.023,00 denarë në vitin 2018; 541.352,00 denarë në vitin 2019 dhe 726.548,00 denarë në vitin 2020 (zërat buxhetore 425310, 425320 dhe 425990). Gjykata në Veles ka shpenzuar 372.632,00 denarë në vitin 2018; 120.216,00 denarë në vitin 2019; dhe 3.466,00 denarë në (zërat buxhetore 425310, 425320 dhe 425990). Fondet janë shpenzuar kryesisht për ndihmë juridike falas.²⁵

Drejtoria për Zbatimin e Sanksioneve²⁶

Duke pasur parasysh strukturën dhe kompetencat e përcaktuara me ligj, Drejtoria për Zbatimin e Sanksioneve në përgjigjen zyrtare i ka përfshirë edhe informacionet lidhur me burgjet (Idrizovë dhe

Ohër) dhe Burgun për të Mitur Ohër. Institucioni ka bërë me dije caktimin e fondeve të zbatuara në përputhje me Udhëzimin për Shpërndarjen e Fondeve nga buxheti bazë për njësitë e përfutuesve. Përveç kësaj, institucioni nuk shfrytëzon asnjë mbështetje nga ekspertë të jashtëm.

Në regjistrat kontabël për vitin 2018, 2019 dhe 2020, Drejtoria nuk ka pranuar donacione nga donatorë të brendshëm. Nga ana tjetër, në evidencën kontabël për Burgjet Ohër dhe IEK Tetovë, UNICEF-i ka dhuruar 2 televizorë dhe laptopë (në vlerë prej 92.798 denarësh) dhe UNDP-ja ka dhuruar 2 projektorë dhe 2 laptopë (në vlerë prej 148.216 denarësh). Nuk janë treguar donacione të tjera nga donatorë privatë.

Gjatë seancës intervistuese, përfaqësuesit kanë treguar se institucioni i shfrytëzon rregullisht të gjitha fondet e caktuara dhe ka bashkëpunim të mirë me autoritetet e tjera kompetente.²⁷

Institucioni Edukativo-Korrektues Tetovë

Për shkak të punimeve ndërtimore, për një periudhë të kufizuar kohore, fëmijët janë destinuar në burgun e Ohrit dhe stafi është dërguar në institucione të tjera. Që nga 3 nëntori 2020, fëmijët e parë u mirëpritën në vendndodhjen e re (7 individë).

Në bazë të analizës së raporteve financiare të dorëzuara, sa i përket mjeteve të kërkuara dhe të aprovuara, mund të konstatohet se IEK-ja Tetovë ka pranuar shumë më pak fonde sesa që ka kërkuar. Përveç kësaj, realizimi është dukshëm më i ulët sesa plani i miratuar. Kjo mund të shihet nga tabela e mëposhtme:

Tabela nr. 6 - Buxheti i kërkuar dhe i aprovuar në periudhën 2018-2020

(në denarë)

Viti	Buxheti i kërkuar	Buxheti i aprovuar	% e aprovuar / I kërkuar	Shuma I shpenzuar	% e shpenzuar /i aprovuar
2018	3.370.000	1.987.100	59%	1.922.644	97%
2019	4.200.000	1.513.110	36%	1.283.187	85%
2020	4.458.000	4.308.566	97%	2.886.490	67%

²⁵ Informacionet e dhëna me bazë kërkesën për qasje të lirë në informacione me karakter publik, të dorëzuara më 18 gusht 2021.

²⁶ Përfshin informacione mbi burgjet (Idrizovë dhe Ohër) dhe Burgun e të Miturve Ohër.

²⁷ Informacionet e dhëna me bazë kërkesën për qasje të lirë në informacione me karakter publik, të dorëzuara më 18 gusht 2021 dhe intervistën e zbatuar.

Në bazë të informacioneve të paraqitura, mund të konstatohet se në vitin 2018 dhe 2019, IEK-së - Tetovë i janë miratuar shumë më pak mjete sesa ato që ka buxhetuar. Kjo është padyshim rezultat i faktit se institucioni në këtë periudhë nuk e ka kryer punën e rregullt dhe karakterizohet me përqindje të lartë të shpenzimit të fondeve. Në vitin 2018, shpenzimet kryesisht u referohen kostove të pagimit me akte detyruese dhe shpenzimeve për shërbime komunale në vitin 2019 - për shërbimet komunale dhe shpenzimet e tjera për të cilat nuk ka në dispozicion informacione shtesë.

Në vitin 2020, kur institucioni pritej të fillonte funksionimin e rregullt në objektin e ri, plani i miratuar në raport me planin e buxhetuar ishte 97%. Nisur nga fakti se institucioni ka filluar të funksionojë në fund të vitit (nëntor) ka pasur realizim më të ulët të planit të miratuar (67%). Kjo çështje u konfirmua edhe gjatë intervistës me përfaqësuesit e IEK-së. Në vitin 2020, 84% të fondeve janë shpenzuar kryesisht për materiale dhe inventar të vogël, shërbime kontraktuese dhe shpenzime për shërbimet komunale.

Në analizë nuk janë marrë parasysh pagat e punonjësve në institucion, të cilat në vitin 2019 janë rritur për 14% krahasuar me vitin 2018 dhe në vitin 2020 për 53% krahasuar me vitin 2019. Pavarësisht rritjes së pagave, gjë që tregon për punësime të reja, institucioni ka ende vende vakante: nëpunës i lartë, arkivist, kuzhinier dhe komandant i policisë së burgjeve, si dhe 15 oficerë të rinj korrektues. Në këtë drejtim, duke supozuar se shpenzimet janë të ndara në mënyrë të barabartë sipas muajve, dhe duke marrë parasysh shpenzimet për vetëm dy muaj për sa kohë që fëmijët ishin të pranishëm në institucionin e ri, mund të përlogaritet kostoja mesatare për fëmijë në vitin 2020, që arrin 325.197,00 denarë. IEK-së Tetovë i është ofruar mbështetje nga mësuesit të cilët paguhen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe angazhohen me fëmijët.

Sa i përket donacioneve, IEK-ja Tetovë në vitin 2018 ka pranuar donacione nga donatorë të brendshëm (automjet pasagjerësh, televizorë, kompjuterë, laptopë) dhe një transferim nga Drejtoria për Zbatimin e Sanksioneve në shumë prej 2.699.297,00 denarësh. Në vitin 2019, IEK-ja Tetovë ka siguruar kompjuterë, laptopë dhe printerë nga një donacion turk në vlerë prej 218.782,00 denarësh. Institucioni mban evidencë për çdo donacion në kontabilitetin e tij. Veç kësaj, institucioni ka shënuar prioritetet e tij për të ardhmen - donacione për kondicionerë ajri dhe makineri bujqësore në vlerë prej 1.200.000,00 denarësh.

Punonjësit ndjekin rregullisht trajnime lidhur me Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët, kryesisht të organizuara nga Sektori i Policisë së Burgjeve.

Gjatë sesionit intervistues përfaqësuesit e institucionit kanë sugjeruar disa tendenca të rëndësishme duke përfshirë praktikën e reduktimeve të kërkesave buxhetore nga Ministria e Financave, punësimin e rregullt për pozitat vakante (Drejtoria jep miratimin që më vonë refuzohet nga Ministria e Financave); sigurimin e ushqimit, veshmbathjes dhe këpucëve për fëmijët, të cilat shpesh sigurohen me anë të donacioneve etj. Në punën e institucionit janë ende të pranishme disa sfida: sigurimi i burimeve për vizita të vazhdueshme të fëmijëve nga familjet e tyre në përputhje me ligjin, vazhdimi i aftësimit të tyre arsimor dhe profesional, qasje më transparente në miratimin e buxhetit të kërkuar të institucionit kryesisht për faktin se shumica e akorduar ka qenë e paracaktuar etj.²⁸

Fakulteti i Sigurisë – Shkup

Në periudhën 2018-2020 Fakulteti i Sigurisë – Shkup nuk ka mbajtur apo organizuar trajnime për tema që kanë të bëjnë me Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët. Si pasojë, Fakulteti nuk ka shpenzuar fare fonde, e as nuk ka marrë donacione për këtë qëllim.

Fakulteti i Sigurisë nuk ka akte të brendshme në lidhje me Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët.²⁹

Institucioni Publik për përkujdesje ndaj fëmijëve me probleme arsimore dhe sociale dhe me sjellje të dëmtuar


Duke përfaqësuar një nga institucionet kyçe në sistemin e drejtësisë për fëmijë, institucioni është kompetent për dhënien e disa shërbimeve të mbrojtjes sociale, ku përfshihen: akomodimi i fëmijëve me asistencë dhe mbështetje 24 orë nga profesionistët, ushqimi, veshmbathja dhe kujdesi shëndetësor, dhënia e aksesit në arsim, përvetësimi i aftësive, aktivitetet kulturore dhe rekreative, akomodimi i fëmijëve në konflikt me ligjin nga 14 deri në 18 vjeç, strehimi i fëmijëve të rrugës për një periudhë deri në 7 ditë etj. Në bazë të Ligjit të Drejtësisë për Fëmijët, institucioni pritet të ofrojë strehim afatshkurtër të individëve të referuar në zbatimin e një mase - referim në qendrën për të mitur të lëshuar nga gjykata dhe zbaton masa afatshkurtra që ndikojnë në personalitetin dhe sjelljen e të miturit.

²⁸ Informacionet e dhëna me bazë kërkesën për qasje të lirë në informacione me karakter publik, të dorëzuara më 18 gusht 2021 dhe intervistën e zbatuar.


²⁹ Informacionet e dhëna me bazë kërkesën për qasje të lirë në informacione me karakter publik, të dorëzuara më 18 gusht 2021.

Sa i përket analizës financiare të shpenzimeve, buxheti i institucionit është dukshëm më i lartë se realizimi i shpenzimeve (përveç pagave), pra realizimi apo fondet e miratuara dhe shpenzuara në raport me buxhetin është 57% në vitin 2018 dhe 2020, dhe në vitin 2019 realizimi arrin vetëm 46%. Megjithatë, realizimi nga viti në vit ka një trend në rritje - është rritur me 16% në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 dhe 15% në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, ose që nga fillimi i periudhës së vëzhguar realizimi është rritur me 34% (shih grafikun më poshtë). Pagat janë duke u rritur, me rritje nga 45% në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 dhe 21% në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, ose nga fillimi i periudhës së analizuar, pagat janë rritur me 75% (shih grafikun më poshtë). Kjo mund të jetë rezultat i punësimeve të reja dhe/ose rritjes së pagave të punonjësve ekzistues, gjë që vërtetohet nga raporti vjetor për vitin 2020 ku vërehet se institucioni ka staf të mjaftueshëm profesional, por ka mungesë të stafit administrativ dhe teknik.

Grafiku nr. 4 - Fondet e kërkuara dhe të aprovuara në periudhën 2018-2020



Grafiku nr. 5 – rritja e kostove (në %)



Kostot për fëmijë nuk mund të përlogaritëshin. Janë paraqitur shpenzimet totale që janë buxhetuar dhe realizuar sipas viteve, por numri i fëmijëve të akomoduar është siguruar vetëm për vitin 2020 (33 fëmijë). Për më tepër, institucioni ka edhe aktivitete të tjera si përgatitja e vakteve falas, aktivitete për personat e zhvendosur, të pastrehët etj.³⁰

Instituti i Veprimtarive Sociale

Instituti i Veprimtarive Sociale monitoron rreziqet sociale që lidhen me Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët, pra fëmijët në konflikt me ligjin, si dhe zbatimin e tij në sistemin e mbrojtjes sociale. Për këtë qëllim, Instituti përgatit Raportin mbi zbatimin e Ligjit të Drejtësisë për Fëmijët nga qendrat për punë sociale dhe ia dorëzon Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale.

Në pajtim me Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët, Instituti i Veprimtarive Sociale ofron trajnime lidhur me Ligjin, ndërsa këshilltarë nga Instituti kanë marrë pjesë në trajnime lidhur me zbatimin e Ligjit, në vitet 2018, 2019 dhe 2020. Megjithatë, nuk janë ndarë fonde specifike për këtë qëllim.

Përveç kësaj, në bazë të ankesave të personave fizikë dhe juridikë të parashtuara përmes MPPS-së, Instituti është i autorizuar të kryejë mbikëqyrjen e punës profesionale të qendrave për punë sociale dhe institucioneve.

Në përgjigjen zyrtare thuhet se të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me Ligjin e Drejtësisë së Fëmijëve janë realizuar me anë të burimeve të tyre të brendshme njerëzore dhe teknike, pa donacione vendase dhe të huaja. Nuk janë sugjeruar artikuj të veçantë për këtë qëllim.

Gjatë sesionit intervistues, përfaqësuesit e kanë theksuar përvojën e gjerë të Institutit në trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë për fëmijë në Maqedoninë e Veriut. Instituti po ashtu ka traditë të gjatë bashkëpunimi me një sërë donatorësh të huaj dhe organizata vendase të shoqërisë civile (përfshirë UNICEF-in, UNDP-in etj.) kryesisht në dhënien e trajnimeve mbi drejtësinë për fëmijët. Instituti është i përfshirë rregullisht në grupet përkatëse të punës për zhvillimin e politikave në këtë sektor. Së fundi, institucioni nuk përballet me sfida të konsiderueshme në aspektin e burimeve njerëzore, por nuk merr fonde për ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin profesional të punonjësve.³¹

³⁰ Informacionet e dhëna me bazë kërkesën për qasje të lirë në informacione me karakter publik, të dorëzuara më 18 gusht 2021.

³¹ Informacionet e dhëna me bazë kërkesën për qasje të lirë në informacione me karakter publik, të dorëzuara më 18 gusht 2021 dhe intervistën e zbatuar.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Sipas informacioneve të dorëzuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), nuk janë shpenzuar mjete nga buxheti për aktivitete që kanë të bëjnë me Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët, nuk janë paraparë vende pune për detyra që kanë të bëjnë me këtë ligj, të punësuarit nuk kanë ndjekur trajnime lidhur me drejtësinë për fëmijët dhe nuk janë planifikuar apo miratuar fonde për mbrojtjen e fëmijëve.

MASH ka bërë me dije se kompetenca për trajtimin e këtyre çështjeve paraqet obligim për shkollat fillore të cilat financohen nga vetëqeverisja lokale.³²

Ministria e Shëndetësisë

Ministria e Shëndetësisë nuk ka dhënë përgjigje zyrtare përkërkesën për qasje të lirë në informacione me karakter publik. Ndonëse është ngritur një procedurë ankimore dhe ASPI-ja ka marrë Vendim për të udhëzuar institucionin në dorëzimin e një përgjigjeje, Ministria nuk ka dhënë përgjigje zyrtare në afatin e parashikuar.

Ministria e Punëve të Brendshme

Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka kërkuar mjete nga Buxheti i RMV-së për zhvillimin e fushatave informuese për të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre. Fushatat parandaluese që realizohen nga Departamenti i Parandalimit/Njësia e Parandalimit me qëllim ndërjegjësimi publik për të drejtat e fëmijëve realizohen kryesisht me mbështetjen financiare të OSBE-së. Fushata konsiston në shpërndarjen e materialit të botuar promovues. Sa i përket forcimit të kapaciteteve të policëve për trajtimin e fëmijëve viktime, fëmijëve në konflikt me ligjin dhe fëmijëve në kontakt me ligjin, MPB-ja ka deklaruar se stafi i tyre ka ndjekur rregullisht trajnime të organizuara nga UNICEF-i, Ambasada Franceze dhe ICITAP-i. Për shembull, në vitin 2018 në kuadër të projektit "Trajtimi policor i viktimave të krimit" janë zhvilluar trajnime kaskadë me punonjës policie, me fokus të veçantë tek fëmijët viktime, viktime të dhunës në familje, trafikim me qenie njerëzore dhe viktime të ngacmimeve seksuale.

Mbi bazën e treguesve të përgatitur nga Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve, MPB-ja ka krijuar sistemin e evidencës dhe mbledhjes së të dhënave. Ky aktivitet zbatohet me fondet e tyre të brendshme.³³

Ministria e Drejtësisë

Në pajtim me Ligjin për Ndhimë Juridike Falas dhe Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët, Ministria e Drejtësisë është kompetente për ndarjen e mjeteve buxhetore për ndihmë juridike falas për pagesën e avokatëve. Fondet u transferohen shoqatave të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe klinikave juridike, si dhe avokatëve për ofrimin e ndihmës juridike dytësore. Numri i fëmijëve të përfaqësuar me ndihmë juridike falas ishte 55 në vitin 2018; 49 në vitin 2019 dhe 65 fëmijë në vitin 2020. Realizimi i këtyre mjeteve në raport me shumën e buxhetuara është jashtëzakonisht i ulët - 6% në vitin 2018 dhe 2020 dhe vetëm 3% në vitin 2019.

Ministria e Drejtësisë nuk ka buxhetuar ose shpenzuar fonde për procedura ndërmjetësimi në periudhën e përmendur më lartë.

Krahas dhënies së fondeve për ndihmë juridike falas, Ministria e Drejtësisë buxheton fonde për kompensimin e fëmijës i cili është viktimë ose i dëmtuar nga një akt i përcaktuar me ligj si krim i dhunës (në përputhje me nenin 151 paragrafin 1 të Ligjit të Drejtësisë për Fëmijët). Programi për ndarjen e këtyre fondeve publikohet çdo vit në Gazetën Zyrtare. Fondet buxhetohen dhe paguhen me anë të Programit 10 - Administrim, llogaria 464 - Transferime të ndryshme. Nga informacionet e paraqitura në tabelën e mëposhtme mund të konstatohet se është paguar një shumë më e lartë se sa ishte buxhetuar fillimisht në secilin prej tri viteve të analizuara. Megjithatë, nuk ka të dhëna se sa fëmijë janë kompensuar me këto fonde.

Përveç mjeteve të planifikuara për ndihmë juridike falas dhe kompensim për fëmijët, Ministria e Drejtësisë është kompetente edhe për planifikimin e fondeve të tjera në pajtim me Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët. Megjithatë, në bazë të informacioneve të dorëzuara, këto mjete kanë një përqindje shumë të vogël të realizimit - 35% në vitin 2018, 55% në vitin 2019 dhe 53% në vitin 2020.

³² Informacionet e dhëna në bazë të kërkesës për qasje të lirë në informacione me karakter publik të dorëzuara më 18 gusht 2021 dhe ankesës së dorëzuar më 17 shtator 2021.

³³ Informacionet e dhëna me bazë kërkesën për qasje të lirë në informacione me karakter publik, të dorëzuara më 18 gusht 2021.

Tabela nr. 7 – Zërat buxhetorë për drejtësinë për fëmijët nga Ministria e Drejtësisë

(në denarë)

Ministria e Drejtësisë - zërat buxhetorë për drejtësinë për fëmijët	2018	2019	2020
Fondet për ndihmë juridike falas të aprovuara në buxhet	3.000.000	5.000.000	5.000.000
Fondet e shpenzuara për ndihma juridike falas	184.450	170.400	319.600
Numri i fëmijëve të përfaqësuar	55	49	65
Fondet për kompensim të aprovuara në buxhet	500.000	1.000.000	1.000.000
Fondet e shpenzuara për kompensim	651.010	4.321.894	1.119.600
Shpenzimet e tjera në pajtim me Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët të miratuara në buxhet	2.400.000	2.400.000	2.400.000
Fondet e shpenzuara për shpenzime të tjera në pajtim me Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët	851.234	1.322.454	1.260.700

Edhe pse Ministria e Drejtësisë në buxhetin e saj planifikon fonde për aktivitete që kanë të bëjnë me Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët, nuk ka miratuar asnjë akt të brendshëm që rregullon vetë procesin e buxhetimit, përcaktimin e fondeve dhe shpërndarjen e tyre.

Gjatë sesioneve intervistuese, përfaqësuesit kanë elaboruar kompetencat e tyre në fushën e drejtësisë për fëmijët dhe kanë identifikuar disa sfida në punën e tyre, duke përfshirë rekrutimin me kohë të burimeve njerëzore (pak pozita mbeten vakante).³⁴

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale nuk ka dhënë përgjigje zyrtare për kërkesën për qasje të lirë në informacione me karakter publik. Ndonëse është ngritur një procedurë ankimore dhe ASPI-ja ka marrë Vendim për udhëzimin e institucionit për dorëzimin e një përgjigjeje, Ministria nuk ka dhënë përgjigje zyrtare në afatin e parashikuar.

Avokati i Popullit

Në periudhën 2018-2020 Avokati i Popullit nuk ka kërkuar fonde nga Buxheti i RMV-së për aktivitete të ndërgjegjësimit publik dhe zhvillimin e fushatave informuese për të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre në pajtim me Planin Operacional për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve dhe aktivitetet lidhur me

Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët. Gjithashtu, Avokati i Popullit nuk ka pranuar donacione për këtë qëllim, nuk ka shfrytëzuar asistencën e ekspertëve dhe nuk ka ofruar vende pune që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit të Drejtësisë për Fëmijët. Këto informacione nuk janë në përputhje me informacionet e paraqitura në faqen e internetit të institucionit, në veçanti me informacionet se është themeluar Departamenti për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Për sa i përket sfidave më të mëdha në zbatimin e Ligjit të Drejtësisë për Fëmijët, zyra e Avokatit të Popullit në raportin e saj vjetor për vitin 2020 ka sugjeruar disa sfida praktike: (1) sigurimi i avokatit për fëmijët në rastet kur është i detyrueshëm me ligj; (2) mungesa e interesit të avokatit për çështjet ku përfshihen fëmijë; (3) mungesa e listave të përditësuara të avokatëve të trajnuar në segmentin e drejtësisë për fëmijët në komisaritet e policisë në shkallë vendi; (4) përfshirja e të njëjtit avokat në disa stacione policore në të gjitha rastet që kanë të bëjnë me drejtësinë për fëmijët; (5) rastet e improvizimit në procedurë kur nuk është i pranishëm avokati etj.³⁵³⁶

³⁴ Informacionet e dhëna me bazë kërkesën për qasje të lirë në informacione me karakter publik, të dorëzuara më 18 gusht 2021 dhe intervistën e zbatuar.

³⁵ Raporti vjetor për vitin 2020, Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, p. 108 – 109, i disponueshëm në: <http://ombudsman.mk/CMS/Upload/NarodenPravobranitel/upload/Godisni%20izvestai/GI-2020/GI-2020.pdf>

³⁶ Informacionet e dhëna në bazë të kërkesës për qasje të lirë në informacione me karakter publik të dorëzuar më 18 gusht 2021 dhe ankesës së dorëzuar më 17 shtator 2021.

Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Kërkesa për qasje të lirë në informacione publike është dorëzuar në të gjitha Prokuroritë Publike në mbarë vendin dhe në Prokurorinë Publike të RNM-së (ZPP).³⁷ ZPP-ja ka dorëzuar një përgjigje zyrtare se nuk ka mundur të përgjigjet në pyetjet konkrete për faktin se në Rregulloren e klasifikimit të shpenzimeve të lëshuar nga Ministria e Financave, nuk janë paraparë zëra të veçantë shpenzimesh për këto kosto. Kostot për këta zëra janë paraqitur në mënyrë kumulative në zërin e shpenzimeve 425 – Shërbime kontraktuese. Gjithashtu, ZPP-ja ka bërë me dije se nuk janë miratuar akte të brendshme për

KSHPDF-ja merr financim nga Ministria e Drejtësisë si përfitues dytësor i buxhetit. Nuk ka një program të pavarur për nevojat e KSHPDF-së dhe fondet janë miratuar në kuadër të programit 10 - Administrata, llogaria buxhetore 637 në llogarinë 420 - Shpenzimet e udhëtimit dhe të jetesës, 425 - Shërbimet me kontratë dhe 426 - Shpenzimet e tjera rrjedhëse.

Shpenzimet e paguara përmes llogarisë 420 dhe 426 janë të papërfillshme, prandaj pothuajse të gjitha mjetet paguhen përmes llogarisë 425 (Shërbimet kontraktuese), ku më së shpeshti paguhen të punësuarit me kontratë ose honorar. Tabela më poshtë paraqet shpenzimet sipas viteve:

Tabela nr. 8 - Buxheti i KSHPDF-së i transferuar përmes llogarive të ndryshme buxhetore

Llogaria nr.	2018		2019		2020	
	I aprovuar	I shpenzuar	I aprovuar	I shpenzuar	I aprovuar	I shpenzuar
420	600.000	2001	600.000	41.830	600.000	3.667
425	1.500.000	931.873	1.500.000	1.282.962	1.500.000	1.257.028
426	6.000	5.010	-	-	-	-
Gjithsej	2.106.000	938.884	2.100.000	1.324.792	2.100.000	1.260.695

buxhetimin në lidhje me drejtësinë për fëmijët. Për më tepër, institucioni nuk ka marrë donacione nga donatorë të brendshëm ose të huaj në periudhën nga 2018-2020. Gjithashtu, stafi i ZPP-së nuk ka marrë pjesë në trajnime lidhur me drejtësinë për fëmijët në periudhën e sipërpërmendur. Së fundi, vetëm Prokuroria Publike në Shkup ka krijuar një Njësi të veçantë për Drejtësi për Fëmijët. Deri më tani është punësuar vetëm 1 zyrtar, megjithëse në njësi janë paraparë të punësohen gjithsej 6 punonjës.

Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve

Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve ka dhënë përgjigje për pyetjet në kërkesën për qasje falas në informacione me karakter publik, por nuk ka dorëzuar dokumentet e nevojshme të kërkuara nga IKSE-ja. Si rezultat i kësaj, informacionet janë paraqitur vetëm në bazë të përgjigjes së dorëzuar zyrtare.

Nuk janë miratuar akte të veçanta që rregullojnë buxhetimin e zërave dhe metodologjinë për përcaktimin e nevojave të institucioneve lidhur me Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët. KSHPDF-ja shfrytëzon asistencën e ekspertëve në shumë prej 30.000,00 denarësh në vit, kurse për shkak të shumës nuk zhvillohet asnjë procedurë e prokurimit publik. Institucioni nuk ka marrë donacione në periudhën nga 2018-2020. Nga ana tjetër, KSHPDF-ja ka treguar se ka nevojë për donacione për përgatitjen, përkthimin dhe botimin e broshurave dhe publikimeve specifike, si dhe për përgatitjen e raporteve për fëmijët viktime, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët e rrugës, gjatë sesionit intervistues, përfaqësuesi i Këshillit Shtetëror e ka përshkruar qartë pozicionin e Këshillit si “emër i madh, kompetenca të kufizuara”. Gjithashtu, janë theksuar një sërë sfidash nga ana operative, duke përfshirë: mungesën e ambienteve të përshtatshme të punës, financimin e kufizuar, mungesën e interesit të vepruesve, si dhe mungesën e koordinimit dhe shpërndarjes së informacioneve ndërmjet subjekteve pjesëmarrëse dhe të përfaqësuesve të tyre në Këshill.³⁸

³⁷ Pothuajse të gjitha prokuroritë publike kanë dorëzuar një përgjigje zyrtare se Prokuroria Publike e RNM-së është kompetente për të dhënë përgjigje zyrtare në kërkesë.

³⁸ Informacionet e dhëna në bazë të kërkesës për qasje të lirë në informacione me karakter publik të dorëzuara më 18 gusht 2021, ankesës së dorëzuar më 17 shtator 2021, dhe intervistës së zbatuar.

Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale

Kërkesa për qasje të lirë në informacione me karakter publik u janë dërguar të gjitha 80 komunave në Maqedoninë e Veriut dhe Qytetit të Shkupit.³⁹ Në bazë të informacioneve të dorëzuara, mund të konstatohet se vetëm 5 komuna (Manastiri, Kavadari, Kumanova, Struga dhe Velesi) kanë ndarë mjete në buxhetin e tyre për këshillat lokale për parandalimin e delikuencës së fëmijëve. Shuma e ndarë për këtë qëllim është prej 30.000 deri në 200.000 denarë. Megjithatë, vetëm dy njësi të vetëqeverisjes lokale kanë shpenzuar fondin për këtë qëllim (Kavadari dhe Velesi). Shuma mbetet dukshëm e ulët - nën 60.000 denarë (1.000.00 euro) në nivelin vjetor. Ka pasur vetëm disa shembuj donacionesh për mbështetjen e aktiviteteve që lidhen me drejtësinë për fëmijët, me financim të kufizuar (për shembull, organizimi i një kampi veror). Sipas informacioneve të dorëzuara, janë krijuar gjithsej 31 këshilla lokale për parandalimin e delikuencës së fëmijëve.

Duhet të merren parasysh edhe informacionet se gjatë seancës intervistuese me përfaqësuesit e palëve relevante në fushën e drejtësisë për fëmijët, është rekomanduar shuma prej 200.000 denarësh si adekuate për buxhetin vjetor të këshillave lokale për parandalimin e delikuencës së fëmijëve.

Disa bashkëbisedues gjatë seancave intervistuese kanë theksuar rëndësinë e këshillave lokale në sistemin e përgjithshëm të drejtësisë për fëmijë dhe nevojën për ndarjen e fondeve bazë për aktivitetet e tyre fillestare (për shembull, 200.000 denarë në nivelin vjetor).^{40,41}

³⁹ Komunitat e Gazi Babës, Gostivarit, Likovës dhe Tearcës nuk kanë dërguar përgjigje zyrtare në kërkesën për qasje të lirë në informacione me karakter publik. Ndonëse është ngritur një procedurë ankimore dhe ASPI-ja ka marrë Vendim për të udhëzuar komunitat e sipërpërmendura që të dorëzojnë përgjigje, asnjëra nga ato nuk ka dhënë përgjigje zyrtare në afatin e parashikuar.

⁴⁰ Për shembull, kjo është sugjeruar gjatë intervistave me Këshillin Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve, Institutin e Veprimtarisë Sociale etj.

⁴¹ Informacionet në këtë pjesë të analizës kanë si bazë kërkesat për qasje të lirë në informacione me karakter publik, të dorëzuara në 80 komuna dhe Qytetin e Shkupit, si dhe 28 ankesat e dorëzuara më 17 dhe 20 shtator 2021. Siç u tha, katër komuna nuk kanë dhënë përgjigje zyrtare për kërkesat.

Konkluzionet

Në bazë të kërkimit të zbatuar, mund të nxirren konkluzionet e mëposhtme:

- ▲ Mungon një qasje sistematike për shpenzimet e qeverisë në nivelin kombëtar dhe atë lokal në lidhje me drejtësinë për fëmijët. Në bazë të kërkimit kompleks që u zbatua, u mbledhën vetëm informacione të pjesshme mbi shpenzimet specifike për disa institucione. Disa institucione me relevancë të lartë nuk dorëzuan përgjigje zyrtare⁴² edhe pse është ngritur një procedurë ankimore. Në disa raste u identifikua një mospërputhje mes informacioneve të paraqitura në përgjigjet zyrtare dhe në raportet financiare zyrtare, bilancet, faqet e internetit etj. Si rezultat i kësaj, mund të konkludohet se sistemi i klasifikimit buxhetor të zërave dhe llogarive nuk siguron se programet kyçe të drejtësisë për fëmijë janë të identifikueshme dhe se ato kanë zëra dhe programe të qarta buxhetore, me të cilat mund të vlerësohet me saktësi se sa përcakton qeveria për këtë qëllim.
- ▲ Disa institucione kanë theksuar se shpenzimet e përcaktuara për drejtësinë për fëmijët nuk përlogariten ndaras, por së bashku me shpenzimet e tjera të ngjashme, konform klasifikimit të shpenzimeve të lëshuar nga Ministria e Financave. Është ky rasti me pothuajse të gjitha institucionet që aktualisht kanë shpenzuar shuma të caktuara për drejtësi për fëmijët.
- ▲ Disa nga institucionet nuk janë në dijeni për përgjegjësitë në sistem⁴³ ndërsa disa nga institucionet kanë dërguar përgjigje të pjesshme ose jo të plota.
- ▲ Disa institucione që u kontaktuan qoftë me anë të kërkesave për qasje të lirë në informacione me karakter publik, qoftë me anë të intervistave, kanë treguar drejtpërsëdrejti ose tërthorazi se institucionet nuk janë në dijeni se janë pjesë e Planit Operacional për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve. Këto institucione janë: Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Agjencia për Rini dhe Sport, Dhoma e Avokatisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Qendra për Arsimitin e të Rriturve etj.
- ▲ dhe Zyra e Avokatit të Popullit.
- ▲ Procedura e parashikuar për hartimin e buxhetit kombëtar zhvillohet në mënyrë të përgjithshme pa pasur hapësirë për ndërhyrje konkrete dhe fleksibilitet. Mospasja e programit specifik dhe llogarisë për drejtësinë për fëmijët kufizon fleksibilitetin e fondeve që duhet të përcaktohen dhe/ose të kërkohen me anë të buxhetit.
- ▲ Sektori i drejtësisë për fëmijë merr një sasi shumë të kufizuar donacionesh nga donatorë vendas dhe ndërkombëtarë. Donacionet evidentohen në kontabilitetin zyrtar në të dy rastet (donacione vendase dhe ndërkombëtare), kur merren produkte ose para të gatshme për të cilat shumica e institucioneve kanë llogari të veçantë të destinuar vetëm për donacione. Është evidente se shërbimet në këtë sektor nuk varen nga donatorët.
- ▲ Pjesëmarrja e stafit në trajnimet lidhur me drejtësinë për fëmijët mbetet të jetë e kufizuar. Stafi i përfshirë në trajnimet lidhur me drejtësinë për fëmijët është i punësuar në QPS dhe më së shpeshti trajnimet janë pa pagesë, të organizuara nga QNPS-ja dhe rrjedhimisht nuk kanë fare implikime financiare.
- ▲ Përderisa në disa komuna janë themeluar këshilla lokale për delikuencën e fëmijëve (sipas informacioneve të dorëzuara - janë 31), vetëm 2 komuna kanë shpenzuar aktualisht mjete për funksionimin e Këshillit. Shuma mbetet dukshëm e ulët - nën 60.000,00 denarë (1.000,00 euro) në nivelin vjetor. Në përmasa të mëdha, këshillat nuk janë në funksion.
- ▲ Vetëm tri gjykata në Maqedoninë e Veriut kanë theksuar se ndajnë fonde për drejtësi për fëmijët. Mesatarisht, këto tri gjykata kanë përcaktuar dhe shpenzuar gjithsej 800.000,00 denarë (13.000,00 euro) në bazë vjetore.
- ▲ Qeveria nuk ka buxhetuar ose shpenzuar fonde për procedura ndërmjetësimi në periudhën e përmendur më lartë.
- ▲ Pothuajse në asnjërin nga institucionet e analizuara nuk janë miratuar akte të veçanta që rregullojnë buxhetimin e zërave dhe metodologjinë për përcaktimin e nevojave të institucioneve lidhur me Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët.

⁴² Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Komunitat e Gazi Babës, Gostivarit, Likovës dhe Tearcës.

⁴³ Këto institucione janë Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Agjencia për Rini dhe Sport, Dhoma e Avokatisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Qendra për Arsimitin e të Rriturve etj.

Rekomandimet

Në bazë të kërkimit të zbatuar dhe konkluzioneve të identifikuar, rekomandohen masat e mëposhtme për të adresuar çështjet në fjalë:

- ▲ Krijimi i një programi të ri buxhetor që do të shfrytëzohet nga të gjitha organet kompetente për zbatimin e Ligjit të Drejtësisë për Fëmijët për të kërkuar fonde në lidhje me këtë ligj;
- ▲ Vendosja e një nënzëre të re ose nënzëreve (llogari 6-shifrore) në Buxhet përmes të cilave do të realizohen fondet në lidhje me Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët. Duke pasur parasysh numrin e madh të institucioneve të përfshira, kjo qasje do të sigurojë një monitorim më të mirë të fondeve të shpenzuara për drejtësinë për fëmijët si dhe kornizën ligjore përmes së cilës institucionet e përfshira mund të kërkojnë dhe shpenzojnë fonde;
- ▲ Zhvillimi i koordinimit më të mirë dhe shkëmbimit të informacioneve ndërmjet institucioneve në kuptimin e detyrimeve që dalin nga Ligji i Drejtësisë për Fëmijët dhe Plani Operacional për Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve. Duhet të krijohet një mekanizëm i mundshëm për raportimin dhe monitorimin e aktiviteteve të të gjitha palëve të interesit të identifikuar, duke përfshirë përgatitjen e raportit vjetor mbi aktivitetet që lidhen me drejtësinë për fëmijët. Raporti duhet t'i dorëzohet një institucioni kompetent të identifikuar me ligj (për shembull, Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve);
- ▲ Mbështetja e vendosjes së mjeteve për shkëmbimin e informacioneve në lidhje me çështjet e drejtësisë për fëmijët brenda institucioneve kompetente. Raportet vjetore të palëve të interesit të identifikuar duhet të përfshijnë informacione mbi aktivitetet që lidhen me drejtësinë për fëmijët;
- ▲ Zhvillimi i zgjidhjes softuerike për nevojat e QPS-së për të evidentuar shpenzimet e shërbimit për drejtësinë për fëmijët, në mënyrë që më mirë të monitorohen përshtatshmëria, efikasiteti dhe efektshmëria e saj;
- ▲ Rishikimi i punës së këshillave lokalë për parandalimin e delikuencës së fëmijëve. Duhet të aplikohet detyrimi për raportim vjetor dhe ose/tremujor. Njësia e vetëqeverisjes lokale duhet të

përcaktojë një minimum buxheti për aktivitetet e këshillave lokalë në drejtim të parandalimit të delikuencës së fëmijëve në bazë të madhësisë, popullsisë dhe rekomandimeve të përmendura në këtë raport (200.000,00 denarë në nivelin vjetor). Edhe sfidat shtesë operationale (përfshirë dhe udhëzimet për madhësinë adekuate të këshillave, motivimin e anëtarëve që të marrin pjesë aktive në punën e këshillave, si dhe udhëzimet për zhvillimin e programit dhe konceptit të aktiviteteve etj.) duhet të merren në konsideratë;

- ▲ Duhet të merret në konsideratë caktimi i mundshëm i fondeve për procedurën e ndërmjetësimit;
- ▲ Duhet të bëhet hartimi i akteve të veçanta që rregullojnë buxhetimin e zërave dhe metodologjinë për përcaktimin e nevojave të institucioneve lidhur me Ligjin e Drejtësisë për Fëmijët dhe
- ▲ Duhet të bëhet zhvillimi i kapaciteteve të punonjësve për raportim të përpiktë dhe akses të lirë në informacione me karakter publik.

Lista e referencave

- ▲ Plani i Veprimit mbi Punësimin e Njerëzve të Rinj (2016-2020);
- ▲ Raporti Vjetor i Institutit të Veprimtarive Sociale (2018-2020);
- ▲ Raporti Vjetor i Këshillit Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut (2018 - 2020);
- ▲ Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (2018 - 2020);
- ▲ Raporti Vjetor i Këshillit Shtetëror për Parandalimin e Delikucencës së Fëmijëve (2018 -2020);
- ▲ Raportet vjetore mbi shkallën e sigurimit, respektimit, avancimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut (Avokati i Popullit, 2018-2020) dhe
- ▲ Këshilli i Evropës R(87)20 në lidhje me reagimin social ndaj delikucencës së të miturve, 1987;
- ▲ Këshilli i Evropës R(88)6 në lidhje me reagimet sociale ndaj delikucencës së të miturve në mesin e njerëzve të rinj që vijnë nga familje migrante, 1988;
- ▲ Këshilli i Evropës R(2003)20 në lidhje me mënyrat e reja të trajtimit të delikucencës së të miturve, 2003;
- ▲ DIREKTIVA (EU) 2016/800 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE KËSHILLIT e 11 majit 2016 mbi masat mbrojtëse procedurale për fëmijët që janë persona të dyshuar ose të akuzuar në procedurë penale;
- ▲ Rezoluta ECOSOC 2005/20 Udhëzues Drejtësie në çështjet që përfshijnë fëmijë viktime dhe dëshmitarë të krimt;
- ▲ Komisioni Evropian, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Raporti për vitin 2018, i disponueshëm në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2019-05/20180417-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-report.pdf> [qasur më 22 tetor, 2021].
- ▲ Komisioni Evropian, Maqedonia e Veriut, Raporti për vitin 2020, i disponueshëm në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/north_macedonia_report_2020.pdf [qasur më 25 tetor, 2021].
- ▲ Komisioni Evropian, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Raporti për vitin 2021, i disponueshëm në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/north-macedonia-report-2021_en [qasur më 22 janar, 2022].
- ▲ Komisioni Evropian, Strategjia e BE-së për të Drejtat e Fëmijës dhe Garancia Evropiane për Fëmijët, E disponueshme në: https://ec.europa.eu/info/policies/justice-and-fundamental-rights/rights-child/eu-strategy-rights-child-and-european-child-guarantee_en#documents [Qasur më: 26 tetor, 2021].
- ▲ Udhëzimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve, 2010;
- ▲ Treguesit për monitorimin dhe zbatimin e Ligjit të Drejtësisë për Fëmijët;
- ▲ Ligji i Llogaritjes së Buxhetit dhe Shfrytëzuesve Buxhetorë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 61/2002, 98/2002, 81/2005, 24/2011, 145/2015 dhe 170/2017);
- ▲ Ligji i Buxhetit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 64/2005; 4/2008; 103/2008; 156/2009; 95/2010; 180/2011; 171/2012; 192/2015 dhe 116);
- ▲ Ligji i Zbatimit të Sankcioneve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 99/2019 dhe 220/2019);
- ▲ Ligji i Familjes (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 80/1992, 9/1996, 38/2004, 33/2006, 84/2008, 67/2010, 156/2010, 39/2012, 44/2012 /2014, 115/2014, 104/2015 dhe 150/2015 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 53/2021);
- ▲ Ligji i Ndhmës Juridike Falas (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 101/2019);
- ▲ Ligji i Drejtësisë për Fëmijët (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 148/2013 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 152/2019 dhe 275/2019);
- ▲ Ligji i Ndërmjetësimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 188/2013, 148/2015, 192/2015 dhe 55/2016)

- ▲ Ligji i Mbrojtjes së Fëmijëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 121/18, 198/18, 104/2019, 146/19, 275/19) dhe
- ▲ Ligji i Mbrojtjes Sociale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 104/2019, 146/2019, 275/2019, 302/2020 dhe 311/2020).
- ▲ Programi Kombëtar për Zhvillimin e Mbrojtjes Sociale (2011-2021) Ministria e Punës dhe Politikës Sociale;
- ▲ Strategjia Kombëtare (2020 - 2025) dhe Plani i Veprimit (2020 - 2022) mbi Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Dhunës;
- ▲ Strategjia Kombëtare e Deinstitutionalizimit në Republikën e Maqedonisë 2018-2027 "Timjanik", Ministria e Punës dhe Politikës Sociale;
- ▲ Strategjia Kombëtare mbi Parandalimin e Delikuencës së të Miturve (2010-2020);
- ▲ Strategjia Kombëtare për Rininë (2016-2025), Agjencia e Rinisë dhe Sportit;
- ▲ Plani Operacional për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve (2015-2017);
- ▲ Raporti i vizitës së Institucionit Publik të Institutit të Kujdesit, Rritjes dhe Arsimimit të Fëmijëve dhe të Rinjve "Ranka Millanoviç" (2019)
- ▲ Raporti i gjendjes në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shpërfillja në pajtim me treguesit e krijuar në 2017, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve - Kavadar, 2019.
- ▲ Raporti i veçantë mbi gjendjen dhe kushtet për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve pa prindër dhe kujdes prindëror të vendosur në një institucion publik të kujdesit në Republikën e Maqedonisë (Avokati i Popullit, 2017);
- ▲ Strategjia e Arsimit (2018-2015), Ministria e Arsimit;
- ▲ Udhëzimet e KB-ve për veprim në lidhje me fëmijët në sistemin e drejtësisë penale;
- ▲ Udhëzimet e KB-ve për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve (Rregullat e Riadit);
- ▲ Rregullat e KB-ve për mbrojtjen e të miturve të privuar nga liria (Rregullat e Havanës);
- ▲ Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës;
- ▲ Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit ("Rregullat e Pekinit");
- ▲ Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.

Shtojca 1 - Kompetencat e autoriteteve të ndryshme konform Planit Operacional për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve (2015-2017);

Objektivi strategjik 1.: Parandalimi parësor		
Rezultati	Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse
1. Rritja e numrit të fëmijëve në institucione parashkollore.	<ol style="list-style-type: none"> Zhvillimi dhe zbatimi i programeve për inkuadrimin e fëmijëve në sistemin arsimor institucional që nga mosha e tyre parashkollore, për qëllimet e përkujdesjes ndaj tyre, arsimimit të tyre, zhvillimit të shkathtësive sociale, nxitjes së vetëbesimit dhe vetëmbrojtjes. Sigurimi i mbështetjes për familjet në inkuadrimin e fëmijëve në institucionet parashkollore 	<p>Ministria e Punës dhe Politikës Sociale</p> <p>Ministria e Arsimit dhe Shkencës</p>
2. Përmbytjet e zhvilluara të programit për parandalimin e delikuencës së fëmijëve në sistemin arsimor.	<ol style="list-style-type: none"> Futja në përdorim të përmbytjeve të programit që kanë të bëjnë me parandalimin e delikuencës së fëmijëve në programin vjetor të punës së shkollës; Zhvillimi i përmbytjeve të programit që kanë të bëjnë me parandalimin e delikuencës së të miturve në programin vjetor të punës së këshillit prindëror; Planifikimi i debateve, forumeve ose punëtorive që kanë të bëjnë me parandalimin e delikuencës së fëmijëve në programin e punës së komunitetit të nxënësve; Ndërgjegjësimi publik i mësimeve, prindërve dhe fëmijëve për parandalimin e delikuencës së fëmijëve, me anë të punëtorive në kuadrin e shkollës. Zhvillimi i aktiviteteve të programit në bashkëpunimin me policinë, vetëqeverisjen lokale, shkollat dhe këshillat prindërorë me përmbytje nga delikuenca e fëmijëve; Formimi i këshillave trepalëshe, në përbërje të prindërve, nxënësve dhe mësimeve për krijimin e politikave shkollore. 	<p>Ministria e Arsimit dhe Shkencës (shkollat)</p> <p>Këshillat komunalë për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve</p> <p>Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve</p> <p>Ministria e Punëve të Brendshme</p> <p>Vetëqeverisja Lokale</p>
3. Hartimi i programeve parandaluese (shëndetësore) nga shërbimet shëndetësore për fëmijë	<ol style="list-style-type: none"> Sjellja e programeve parandaluese për fëmijë dhe zbatimi i tyre në koordinim me shkollat; Fuqizimi i shërbimit të mjekëve amë – pediatërve për avancimin e shëndetit të fëmijëve dhe ndërhyrjes së hershme; Zhvillimi i mekanizmeve për detektimin e hershëm të problemeve dhe dukurive të caktuara; Hapja e këshillimoreve dhe qendrave për fëmijë që përdorin droga dhe substanca të tjera psikotropike 	<p>Ministria e Shëndetësisë</p> <p>Shtëpitë e Shëndetësisë</p>
4. Ndërgjegjësimi publik dhe zbatimi i fushatave informative për të drejtat e fëmijëve dhe për mbrojtjen e tyre	<ol style="list-style-type: none"> Ndërgjegjësimi i përfaqësuesve të mediave për problemin e delikuencës së fëmijëve, me anë të debateve dhe takimeve informative; Hartimi i programeve informative-educative për fëmijët dhe për tërë publikun. 	<p>MSHIA</p> <p>Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, MPPS, MD, MASH</p>
5. Inkuadrimi i komunitetit lokal në realizimin e aktiviteteve parandaluese për parandalimin e delikuencës së fëmijëve	<ol style="list-style-type: none"> Zhvillimi i bashkëpunimit me Këshillin Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve me këshillat komunalë për parandalimin e delikuencës së fëmijëve; Formimi i këshillave lokalë për parandalimin e delikuencës së fëmijëve 	<p>Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve</p> <p>BNJVL</p> <p>dhe vetëqeverisja lokale</p>
6. Zhvillimi i bashkëpunimit të Këshillit shtetëror për parandalimin e delikuencës feminare me Dhomën e avokatëve të Republikës së Maqedonisë; së Veriut	<ol style="list-style-type: none"> Zhvillimi i bashkëpunimit nëpërmjet zbatimit të takimeve, trajnimeve mbi rolin e avokatëve në procedimet ndaj fëmijëve në përputhje me Ligjin për Drejtësi për Fëmijët; Nënshkrimi i Memorandumit për Bashkëpunim. 	<p>Dhoma e avokatëve të RMV-së</p> <p>Këshilli shtetëror për parandalimin e delikuencës feminare</p> <p>Ministria e drejtësisë</p>

Objektivi strategjik 2 : Parandalimi dytësor		
Rezultati	Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse
1. Zhvillimi dhe zbatimi i programeve për njohje dhe identifikim të hershëm të fëmijëve në rrezik në institucionet parashkollore dhe shkollore	<ol style="list-style-type: none"> 1. Fuqizimi i shërbimeve profesioniste në shkollat për njohje dhe identifikim të hershëm të fëmijëve në rrezik; 2. Zhvillimi i programeve për prindërim të përgjegjshëm; 3. Realizimi i programit për këshillimore për prindër dhe fëmijë; 4. Zhvillimi i moduleve për trajnimin e profesionistëve në fushën e mbrojtjes së fëmijëve me qëllim thellimi i njohurive dhe shkathtësive, që t'u përgjigjen nevojave të fëmijëve në rrezik; 5. Zhvillimi i bashkëpunimit ndërsektorial duke synuar ndërhyrjen e mëkohshme. 	<p>Ministria e Punës dhe Politikës Sociale</p> <p>Ministria e Arsimit dhe Shkencës</p> <p>IP Instituti i Veprimtarive Sociale - Shkup</p> <p>Byrja për Zhvillimin e Arsimit</p>
2. Përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve që veprojnë në sistemin e drejtësisë për fëmijët	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillimi dhe aplikimi i metodës së punës – inspektim në shtëpinë e familjeve në rrezik; 2. Zhvillimi i formës së këshillimoreve për të rinj; 3. Realizimi i programit “Qendra Edukative për Prindërit” në qendrat për punë sociale 4. Zhvillimi i familjeve të specializuara përkujdesëse për fëmijë në rrezik 	<p>Ministria e Punës dhe Politikës Sociale</p> <p>Ministria e Arsimit dhe Shkencës</p> <p>IP Instituti i Veprimtarive Sociale - Shkup</p> <p>Qendrat për Punë Sociale</p> <p>Pushteti Lokal</p>
3. Zhvillimi i Rrjetit të qendrave për shëndet mendor për fëmijët dhe këshillimore dhe qendra për fëmijë që abuzojnë alkool, drogë dhe substanca të tjera psikotropike	<ol style="list-style-type: none"> 1. Hapja e qendrave për shëndet mendor për fëmijët; 2. Hapja e qendrave për fëmijë që abuzojnë alkool, drogë dhe substanca të tjera psikotropike; 3. Fuqizimi i bashkëpunimit me institucionet për fëmijë me probleme edukativo-sociale, qendrat për punë sociale dhe shkollat. 	<p>Ministria e Shëndetësisë</p> <p>Shtëpitë e Shëndetit</p>
4. Fuqizimi i kapaciteteve të zyrtarëve të policisë në procedimin me fëmijët në rrezik dhe fëmijët në konflikt me ligjin	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përcaktimi i mundësive të hapjes së hapësirave të veçanta për bisedë me fëmijët në përbërjen e stacioneve policore; 2. Zhvillimi i teknikave për ndërhyrje të hershme; 3. Zhvillimi i programeve me pjesëmarrjen e familjes, komunitetit lokal dhe QPS; 4. Fuqizimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të njësive/ departamenteve për parandalimin e delikucencës së fëmijëve. 	<p>Ministria e Punëve të Brendshme</p>
5. Programet e zbatuara për integrim social të fëmijëve në rrezik	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sjellja e programeve për integrim social të fëmijëve në rrezik me anë të trajnimeve për mësuarjen e shkathtësive, rikualifikimit, zhvillimit të mentorimit, shfrytëzimit të organizuar të kohës së lirë etj.; 2. Bashkëpunimi i këshillave komunalë për parandalimin e delikucencës së fëmijëve me organizata rinore, Agjencinë e Rinisë dhe Sportit, organizata joqeveritare etj. 	<p>BNJVL</p> <p>Ministria e Vetëqeverisjes Lokale</p> <p>Këshillat Komunalë për Parandalimin e Delikucencës së Fëmijëve</p>

Objektivi strategjik 3: Parandalimi terciar		
Rezultati	Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse
1. Trajtimi dhe rehabilitimi i fëmijëve në institucionet edukativo-korrektuese	<ol style="list-style-type: none"> 1. Analiza e gjendjeve në IEK; 2. Zhvillimi i programeve për monitorimin dhe mbështetjen e fëmijëve në institucionet edukativo-korrektuese; 3. Hartimi i instrumenteve të standardizuara për punë individuale gjatë qëndrimit në institucion. 	<p>Ministria e Drejtësisë</p> <p>Drejtoria për Zbatimin e Sanksioneve</p>
2. Aplikimi i masave alternative	<ol style="list-style-type: none"> 1. Informacioni për zbatimin e masave alternative dhe ndërmjetësimit, i hartuar nga Ministria e Drejtësisë; 2. Ndërgjegjësimi i gjykatësve për shqiptimin e masave alternative – vrojtimi mbrojtës tek dënimi me kusht dhe puna e përgjithshme komunitare; 3. Zhvillimi i ndërmjetësimit 	<p>Ministria e Drejtësisë</p> <p>Drejtoria për Zbatimin e Sanksioneve</p> <p>Gjykatat</p>
3. Riintegrimi i fëmijëve pas largimit nga institucioni	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sigurimi i shërbimeve cilësore për fëmijët pas largimit nga institucioni, nga komuniteti lokal; 2. Zhvillimi i programeve me përfshirjen e familjes, komunitetit lokal, institucioneve shëndetësore; 3. Përfshirja e shoqërisë civile gjatë lajmërimit për lloje të ndryshme të shërbimeve. 	<p>BNJVL</p> <p>Komuniteti Lokal</p> <p>Qendrat për Punë Sociale</p> <p>Shoqatat Civile</p> <p>Ministria e Arsimit dhe Shkencës</p> <p>Qendra për Arsimimin e të Rriturve</p>
4. Avancimi i sistemit të evidencës dhe lajmërimit për fëmijët në rrezik, fëmijët viktimë dhe fëmijët në konflikt me ligjin	<ol style="list-style-type: none"> 1. Futja në përdorim të evidencës në të gjitha institucionet relevante; 2. Prokuroria Publike të vendosë një sistem për evidentimin e fëmijëve viktimë; 3. Avancimi i evidencës në nivelin kombëtar; 4. Sigurimi i analizës statistikore. 	<p>Prokuroria Publike</p> <p>Qendrat për Punë Sociale</p> <p>Ministria e Punëve të Brendshme</p> <p>Ministria e Arsimit dhe Shkencës</p> <p>Gjykatat me juridiksion të zgjeruar në RMV</p>

